

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7677 E premte 12 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga VASIL KURETA

Roli global i SHBA dhe Perëndimit është i domosdoshëm



Opinion


Ditës

Nga SULEJMAN MATO

Kur ikin shkrimtarët...

Roli dhe kontributi i SHBA-ve e Perëndimit në ndërtimin e filozofisë, standardeve dhe arkitekturës institucionale të sigurisë, por edhe kontributi ...
Vijon në faqen 20

Ndryshe nga njerëzit e zakonshëm, kur ikin shkrimtarët, lënë një boshllëk të madh brenda zemrës së çdo njeriu që i ka lexuar dhe i ka dashur veprat e tij ...
Vijon në faqen 21



Dokumentet e Prokurorisë së Përgjithshme

Përgjimet zyrtare: Alizoti: Pres Taulantin, mikun nga Librazhdi, mora një dorë të mirë

Njeriu që u përfol si imituesi i zërit të Gon Xhafajt, "kapet mat": Vjen drejtori i Fierit

Do vijë drejtori i Përgjithshëm i Fierit. Mora një pako të mirë. Po pres të vijë Taulanti. Jam me atë shokun nga Librazhdi...", këto janë vetëm disa fraza të shkëputura nga biseda e Fredi Alizotit me miqtë e tij. Këto biseda janë administruar si përgjime nga Prokuroria e Përgjithshme. Fredi Alizoti është dëshmitari që pretendon ...
Në faqen 2

VIKTIMAT PO PUNONIN PER HAPJEN E RRUGES, 1 I PLAGOSUR. PRANGA AUTORIT

MASAKER NE MAT, VRITEN 3 PUNONJES TE BASHKISE

Burrat qëllohen me kallash kur po hanin bukë. Dyshimi, kryeplaku u kërkoi ta kalonin rrugën nga shtëpia e tij. Kryebashkiaku: Telefonata, si e mora vesh krimin



(Në foto) Lokali ku ndodhi vrasja. Autori i arrestuar, Kujtim Koxha

Në faqen 2-3

APLIKIMI

Udhëzimi i DASH: Lotaria Amerikane, si do plotësohet formulari elektronik

Në faqen 11

MISTERI

Ngjarja e rëndë, 13-vjeçarja vritet me thikë në Babrru, në spital e çon i ati

Në faqen 7

KUVEND

Bastet, Ahmetaj: Program i veçantë për të papunët. Braçe: Shtetëzgjoni

Në faqen 4

POETI I NJOHUR

Ndërron jetë Fatos Arapi, Kadare: Arti i tij, i çmuar në kronikën e letërsisë

Në faqen 18-19

NGA DASHNOR KALOÇI



Letra për Ramizin më 1970: Ja pse na sulmon Fadil Paçrami mua dhe Lllazar Siliqin

Në faqen 16-17

Presidenti i kthen parlamentit ligjin: Po shmangët zgjidhja e çështjes

Meta kthen "Teatrin": S'garanton konkurrencë

Artistët protestues falenderojnë kreun e shtetit. Mustafaj: Reflektim

Nga VALENTINA MADANI

Presidenti Ilir Meta për herë të dytë riktheu dhe për rishqyrtim në Kuvend ligjin për Teatrin Kombëtar, të miratuar për herë të dytë nga shumica parlamentare më 20 shtator që i hap rrugë prishjes së Teatrit Kombëtar.



Në dekretin e tij, kreu i shtetit argumenton se pavarësisht amendimit të bërë nga socialistët në seancën e 20 shtatorit, ligji shkel parimet e barazisë përpara ligjit. Sipas presidentit: "Ligji shkel parimet e "barazisë përpara ligjit" dhe "lirisë së veprimtarisë ...
Në faqen 5

DOSJA "AGRON XHAFAJ" DOKUMENTET

Skandali/ "Kunati" i Babales që akuzohet nga PD si aktor: Po pres Taulantin

Përgjimet e Fredi Alizotit: Do vijë drejtori i Fierit, mora pako të mirë

PD: Shteti po fabrikon prova për pushtetin

Do vijë drejtori i Përgjithshëm i Fierit. Mora një pako të mirë. Po pres të vijë Taulanti. Jam me atë shokun nga Librazhdi...". këto janë vetëm disa fraza të shkëputura nga biseda e Fredi Alizotit me miqtë e tij. Këto biseda janë administruar si përgjime nga Prokuroria e Përgjithshme.

Fredi Alizoti është dëshmitari që pretendon që ka bërë zërin e Agron Xhafajt në audiopërgjimin e Babales, por që Partia Demokratike thotë që ai është një "aktor i PS-së".

Deputeti demokrat, që ditët e fundit ka qenë protagonist i skenës politike Ervin Saliانji ka publikuar disa dokumente të Prokurorisë së Përgjithshme me përgjime.

Duke iu referuar çështjes "Babale" dhe videos së Fredi Alizotit, ai thotë se i gjithë shteti është vënë në shërbim të fabrikimit të provave për të shpëtuar pushtetin.

Në dokumentet e publikuara nga Saliانji flitet për bisedat mes Alizotit dhe drejtorit të policisë së Fierit, ku përmendet emri i deputetit të PS Taulant Balla, për të cilin Alizoti në video thoshte se ishte takuar para prokurorisë në kishite dhënë dëshminë se kishte qenë ai që kishte imituar Agron Xhafaj.

Në transkriptin e përgjimit të prokurorisë, sipas Saliانjit drejtori i policisë së Fierit përmend disa herë "Taulantin" dhe "shokun nga Librazhdi".

"XhafajGate!
Gjithë shteti në shërbim të fabrikimit të provave për të shpëtuar pushtetin e tyre politik dhe privilegjet që iu vijnë nga pushteti.

Si u fabrikua "aktori"?!
Përgjimet e prokurorisë faktojnë se Taulanti nga Librazhdi, shoku i Alizotit i përgjau me nr. cel +091 flet me drejtorin e policisë së Fierit dhe me persona të tjerë!

Kushdo mund t'i shohë vetë dokumentet zyrtare të prokurorisë.

Skandali më i madh i faktuar tashmë dhe me dokumente zyrtare Deri tani kemi parë shumë

pak??", shkruan Saliانji. **MARRJA NE PYETJE**

Fredi Alizoti, i dyshuar si aktori që imitoi zërin e Agron Xhafajt në au-

diopërgjimin e Babales, në dëshminë e tij dhënë këtë të enjte në prokurori, ka pranuar se video e përgjuar të publikuar nga Saliانji në

emisionin 'Opinion', e ka realizuar pas datës 1 qershor, pra pas datës kur është marrë në pyetje nga prokuroria.

Ndër të tjera Alizoti ka thënë se videoja dy është bërë pranë selisë së Partisë Demokratike. Sipas dëshmisë së zbardhur, Alizoti ka deklaruar se e ka identifikuar personin që e ka pyetur në video, por nuk ka dhënë detaje të tjera. Gjithsesi ai konfirmoi se u mbetet deklarimeve që ka bërë në prokurori më datë 1 qershor, ku ka pohuar se është ai që ka imituar zërin e Agron Xhafajt me pretendimin se 'Babalja' i kishte premtuar 100 mijë euro që do t'ia paguante deputeti Saliانji.

Fredi Alizoti është njeriu që dyshohet se në audiopërgjimin e njohur si Babalja, imitoi zërin e vëllait të ministrit, Agron Xhafaj. Për akuzën "kallëzim i rremë" prokuroria ka kërkuar masën 'arrest me burg' për të.



Gjykata e Krimeve të Rënda


FREDI ALIZOTI

Në disa përgjime të tjera, "Babalja 2" pranon se rolin e Agron Xhafajt në përgjim e ka luajtur ai dhe se i janë premtuar 100 mijë euro për këtë rol. Madje, në disa biseda, ai tregon se ato para nuk i ka marrë, por Veliu, sipas tij, ka marrë 70 mijë euro përpara se të nisej për në Kosovë.



"BABALJA"

PD ka publikuar e para dëshminë e Albert Veliu, i cili rrëfente se si e ka njohur dhe ka bashkëpunuar me vëllain e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, Agron Xhafaj në trafikun e drogës në Itali. Në intervistën për gazetarin Jetmir Ollidashi, "Babalja" pretendonte se vëllain e Fatmir Xhafajt nuk e përgjoi ai, por është zëri i tij.



"Bashkë me djalin ka fituar azil deri në nëntor 2018"

Dëshmitari "X", Albert Veliu arrestohet në Kosovë, avokati: Të mos ekstradohet

Albert Veliu apo i njohur ndryshe si "Babalja" është arrestuar dje nga policia e Kosovës. Pas akuzave të ngritura nga autoritetet shqiptare, policia kosovare ka arrestuar për llogari të drejtësisë shqiptare Veliu, e njohur ndryshe si "Babalja", protagonist i audiopërgjimit me Agron Xhafaj.

Veliu akuzohet për "kallëzim të rremë" në bashkëpunim si dhe kalim të paligjshëm të kufirit. Ai dëshmoi në prokurori se kishte folur në telefon me vëllain e Fatmir Xhafajt, i cili aktualisht ndodhet në Itali.

Albert Veliu është arrestuar në qendrën e azilit politik në Prishtinë, ndërsa më pas është dërguar në qendrën e paraburgimit.



Albert Veliu

trazuar politikën shqiptare me akuzat dhe kundër akuzave të forta të bëra nga të gjitha palët. Partia Demokratike ka akuzuar

ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj se ka favorizuar vëllain e tij, Agronin, në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, por ky i

AZIL POLITIK?


Siç shkruan avokati, familjarët e Veliu i kanë komunikuar se Veliu bashkë me djalin iu është pranuar azili politik në Kosovë deri në nëntor të 2018.

fundit i ka hedhur poshtë pretendimet e tyre duke i quajtur thjesht "shpifje" të opozitës dhe Partisë Demokratike.

Akuza e parë për "Babalen" lidhet me rolin e tij në audiopërgjimin që u akuzua se implikon në trafik drogë vëllanë e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj.

Pas arrestimit të Albert Veliu në Kosovë, avokati i tij, Tomë Gashi, ka reaguuar duke thënë se një ekstradim drejt Shqipërisë do t'i rrezikonte jetën klientit të tij.

Ai shprehet se duke qëndruar në këto pohime, shpreson që gjykata e Kosovës nuk do të lejojë një ekstradim, duke kujtuar edhe njëherë të drejtat dhe konventave ndërkombëtare.



Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje disa dokumente zyrtare, që sipas saj provojnë sesi Prokuroria ia ka adresuar policisë fabrikimin e provave për të mbrojtur vëllain e ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj, për të cilin opozita pretendon se është i përfshirë në trafik droge në audiopërgjimin e njohur si "Babale". Demokratët Enkelejd Alibeaj dhe Gazmend Bardhi publikuan dy dokumente, të cilat sipas tyre vërtetojnë që hetimet për rastin "Babale" janë kryer nga Fatmir Xhafaj. "Ky është dokumenti i datës 7 qershor 2018, që provon se hetimin për këtë fakt nuk e ka bërë Prokuroria, por Policia e Shtetit. Pra, nëse kanë qenë apo jo bashkë Albert Veliu dhe Agron Xhafaj, e ka hetuar vetë Fatmir Xhafaj. Ky është dokumenti i datës 15 maj 2018, që provon se mostrat e zërit të Agron Xhafajt janë marrë nga eksperti vartës i Fatmir Xhafajt, me pajisjet e Fatmir Xhafajt", tha Gazmend Bardhi. Demokratët i kërkuar publikisht organit të akuzës të përgjigjet se përse prokurorët nuk e kanë verifikuar audiopërgjimin e publikuar nga Ervin Saliqij me Fredi Alizotin, i cili pranon se i është bërë një ofertë nga pala tjetër. "Cila është pala tjetër? Çfarë oferte ka marrë? Kush e ka bërë ofertën? Të gjitha këto duhet të ishin hetuar nga Prokuroria", tha Bardhi. Kurse deputeti Enkelejd Alibeaj akuzoi se Prokuroria nuk heton krimin, por denoncucesit dhe se Agron Xhafaj nuk i hetua kurrë, por u lejua të ikë natën për në Itali. Ai tha se prokuroria nuk ka zhvilluar asnjë hetim për trafikun e drogës. "Jemi këtu për të dëshmuar me prova se si Rama përmes veglave në prokurori nuk heton krimin, por denoncucesit. Nuk arreston trafikantin e drogës, por përndjek gazetaret. Agron Xhafaj nuk i hetua kurrë, por u lejua të ikë natën në Itali, sapo u publikua materiali audio se ai drejtohet trafikun e drogës. Prokuroria e Krimeve të Rënda nuk ka zhvilluar asnjë hetim për trafikun e drogës. Çfarë është bërë me drogën e Tragjas? Çfarë është bërë me personat trafikantë që shfaqen në materialin gazetarit? Rama ka instaluar një shtet privat mafioz. Prokuroria përdoret nga Rama si zyrë e propagandës për manipulimin publik", tha Alibeaj. Deputeti i PD u shpreh ndër të tjera se krimi ka kapur edhe Prokurorinë dhe Shqipëria është shndërruar në diktaturë mafioze. "Krimi tashmë ka kapur edhe Prokurorinë. Prokuroria e Krimeve të Rënda është kthyer në një celulë kriminale. Përdorimi politik i drejtësisë nga Edi Rama është paralajmëruar nga PD që ditën kur në mënyrën e njëanshme u emërua një kryeprokurore vegël e tij. Rama mbron kriminelët me të cilët bashkëpërmes. Shqipëria është shndërruar në diktaturë mafioze", - theksoi z. Alibeaj.



"Babalja", Xhafaj: Të flasë drejtësia, opozita po sulmon policinë

Në debatin mes pozitës dhe opozitës dje u përfshi edhe ministri i Brendshëm, i akuzuar nga demokratët se po shpërdoron detyrën për të mbrojtur vëllain trafikant. Në një deklaratë për mediat, pasi vizitoi ambientet e Task Forcës Speciale bashkë me z. Presidentin e Policisë Kriminale Gjermane, Xhafaj u shpreh se po pret vendimin e prokurorisë dhe gjykatës për këtë çështje, ndërsa shtoi se opozita po sulmon policinë me llumin e këtij vendi. "Nuk preferoj të bëj komente për 'Babaljen'. Kjo çështje i takon drejtësisë. Kam kulturën e nevojshme politike, institucionale dhe ligjore të respektoj Prokurorinë. Kjo çështje është në hetim të plotë. U takon atyre dhe gjykatës të japin verdiktin. Unë jam ministër dhe dua t'u shërbej qytetarëve. Jam i fokusuar në luftën kundër krimit të organizuar. Për këtë kam zgjedhur instrumentet e nevojshme dhe partnerët e duhur. Pala tjetër ka zgjedhur një rrugë tjetër që t'i dalë në krah krimit dhe të sulmojë policinë. Këto janë instrumente dhe partnerë të gabuar. Janë llumi i këtij vendi", deklaroi Xhafaj.

Babalja dhe Alizoti, PD: Tri provat që prokurorët ia lanë në dorë ministrit të Brendshëm

"Babalja", PD: Prokurorët i kërkuar Xhafajt të hetojë të vëllain

"Nuk heton kriminelët, por denoncucesit"



Demokratët Enkelejd Alibeaj dhe Gazmend Bardhi, dje në konferencë për shtyp

EDI PALOKA

Deklaratave të ministrit Xhafaj, sipas të cilit "PD ka zgjedhur partnerë llumin e këtij vendi", Paloka iu përgjigj se, "Xhafaj duket se e ka harruar që llumin e ka në familjen e tij".

VIDEOPËRGJIMI



Balla: Filmimi u bë në oborrin e SHQUP-it nga Florenc Hoxha

Bylykbashi: Prokuroria angazhohet për të mbrojtur Agron Xhafajn

Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi reagoi dje ndaj Prokurorisë së Krimeve të Rënda në lidhje me vendimin e këtij institucioni për moskompetencë për hetimin e bandës së Elbasanit. "Prokuroria e Krimeve të Rënda paska thënë sot se nuk ka kompetencë të hetojë krimin e rëndë të një prej bandave më të rrezikshme të Elbasanit, e cila në shtator të vitit 2017, pothuajse vrau një punonjës policie në një ngjarje të ndodhur në hyrje të Tregut Ushqimor të Elbasanit. Policia e fshehu atë ngjarje derisa u denonca publikisht nga kryetari i PD, Lulzim Basha. Prokurori Gentian Osmani, me anë të një shkresë zyrtare të drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka njoftuar se nuk ka kompetencë për të hetuar këtë bandë", shkruan Oerd Bylykbashi në 'FB'. Sipas tij, Prokuroria e Krimeve të Rënda mbetet e angazhuar



plotësisht për mbrojtur vëllain trafikant droge të Fatmir Xhafaj, duke i dorëzuar të njëjtit prokuror hetimin për kallëzim të rremë për çështjen "Babale", ku është përfshirë edhe deputeti Ervin Saliqij. "Nga ana tjetër, Prokuroria e Krimeve të Rënda është e gjitha e angazhuar për të shpëtuar të dënuarin për trafik droge Agron Xhafaj dhe trafikantët e kriminelë të lidhur me qeverisjen e Edi Ramës përmes hetimit të 'provave' për kallëzim të rremë, të fab-

rikuara në zyrën e Fatmir Xhafaj. Injënti prokuror që shpall moskompetencë për hetimin e krimeve të rënda të bandave të Elbasanit, keqpërdor Prokurorinë e Krimeve të Rënda për të hetuar tërësisht jashtë kompetencës së Krimeve të Rënda, kallëzim që ka bërë narkotrafikanti Agron Xhafaj për 'kallëzim të rremë' që nuk është krim i rëndë. Ky është produkti i reformës Rama-Xhafaj, një prokurori që vepron me telekomandën e pushtetit.

Babalja përplasi sërish opozitën dhe mazhorancën në distancë. Nga foltorja e Kuvendit, Taulant Balla zbuloi personin që sipas tij ka realizuar kamerën e fsheshë me Fredi Alizotin, i akuzuar se ka imituar zërin e Agron Xhafaj, si dhe vendin ku është realizuar intervista. "Ta-shmë në media është konfirmuar që është bërë fiksi në oborrin e SHQUP-it dhe që Partia Demokratike ende nuk thotë kush është gazetari i radhës të videoja e radhës. Se unë nuk di që drejtori i Policisë Bashkiake të Lulit, a të Inspektoratit të Ndërtimit të Lulit të ketë punuar ndonjë ditë gazetar", tha Balla në Kuvend. Sekretari i përgjithshëm i PS-së foli për 3 aktorë, për atë që ai e etiketoi si "Babale 2", ndërsa zbuloi edhe një detaj për gazetarin Ollidashi, i cili intervistoi Albert Velin. "Kemi 3 aktorë të përfshirë në 'Babale 1', Fredi Alizoti, Albert Veliu dhe deputeti i PD, Ervin Saliqij, i cili ka qenë edhe personi që ka vënë në shërbim gazetarin Jetmir Ollidashi dhe që, po aq e rëndë është, nga çfarë është bërë publike, që ky gazetar paska punuar apo ka qenë pjesë e infiltrimit edhe nga Shërbimi Informativ Sh.tëtorë", u shp-reh z. Balla.

EPISA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:
1- "Ndërtësa 3 Kat" - pa trull, me vetem Kati i Parë i regjistruar në ZVRPP Tiranë me sip. 131 m² dhe Kati i Dytë dhe Kati i Tretë ndërtim pa leje, i ndodhur në Rr "Siri Kodra", Tiranë, Zona Kadastrale: 8340, Numri i Pasurisë: 4/171-ND, Vol.9, Faqe 127. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të **Fethi Kaya**. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **12.320.000 Leke**. Ankandi zhvillohet datë **23.10.2018 ora 16.00** në adresën Rr."I. Qemali", Pall."Frateri", K.6.Tiranë.
 Per cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al

3H SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k Rr. "Flah Dalia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë Web: www.3h.al Email: shqj.3h@yaho.com cel:0652095711
 Njofton shpalljen e ankandit nga **dt.11.10.2018 deri ne dt. 19.10.2018** per: sendin e luajtshem mjeti me targe AA 089 OB ne pronesi te Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M
 Çmimi fillestar eshte 993 EURO
Ankandi zhvillohet ne zyrën përmbarimore ne daten 19.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.

PARLAMENTI DEBATET

Debate në seancë mes socialistëve, për mbylljen e kazinove dhe financat e FSHF

Darina Tanushi

Pas vendimit të marrë për mbylljen e të gjitha pikave të bastëve dhe kazinove në qendrat e banuara, Ministri i Financave, Arben Ahmetaj u shpreh dje, në Kuvend se "Për bastet është një moment i duhur për të ndarë historinë në dy epoka: Deri në fund të 2018 dhe pastaj epoka e pastër, nga një janari e tutje" u shpreh Ahmetaj. Gjatë fjalës së tij, Ahmetaj tha se po përgatitet një program rikualifikimi për të gjithë ata që do të dalin të papunë nga mbyllja e kazinove dhe pikave të bastëve. "Po përgatim një program rikualifikimi për të gjithë ata që do të dalin të papunë nga shërbimet e kësaj industrie. Shërbimi Kombëtar i Punës ka nisur punën për hartimin e një programi specifik për një rikualifikim të detyrueshëm. Është iniciativë për t'u përshtetur dhe mbështetur", u shpreh Ahmetaj, ndërsa theksoi se kjo industri u kthye në plagë sociale për vendin, ndaj edhe u mor një vendim drastik për t'i dhënë zgjidhje një herë e mirë. "Në 1 janar nuk do të ketë më pika bastesh dhe kazino elektronike. Çfarë do të bëhet me të ardhurat që nuk do të mbledhë buxheti i shtetit dhe me të punësuarit? Janë shtetësi me bazë, por në raport me plagën sociale, prevalon mbyllja e bastëve dhe kazinove", theksoi Ahmetaj. E ndërsa maxhoranca dje, në Kuvend mbështeti nismën e qeverisë, kreu komisionit të ekonomisë Erjon Braçe propozoi shtetëzim të bastëve. "Shtetëzimi, bëjini monopoli shtetëror që mos të bëni luftë guerille bodrumeve".

INTERPELANCA

Kreu i Komisionit të Ekonomisë dhe ministri i Financave u përballën dje, në një seancë interpelance kërkuar nga Braçe mbi financat e Federatës Shqiptare të Futbollit. "Në asnjë rast nuk do të mbyll gojën para individëve apo institucioneve që kanë fituar imunitet fiskal", tha Braçe. Ministri Ahmetaj pranoi se ka ende informacionet në futboll, por u fokusua te klubet sportive: "Formalizimi në klube është emergjencë. Kanë nisur të reflektojnë paga afër reales, por jemi ende larg". Deklaratat e deputetit Braçe u pritën me duartkrokje nga deputetët socialistë, ku ra në sy Bashkim Fino, që nuk fitoi në garën për kreun e FSHF-së. Sipas Ahmetaj, po përgatitet një ligj i ri për sportin, i cili do t'i japë zgjidhje problematikes në futboll. Në fjalën e tij Braçe tha se ka kërkuar prej muajsh infor-

Bastet sportive, Arben Ahmetaj: Program rikualifikimi për ata që dalin të papunë

Braçe: Shtetëzoni që mos të bëni luftë guerille bodrumeve



Ministri i Financave,
Arben Ahmetaj

Fino nxehtet me ministrin Bushati në Kuvend: Mos qesh, po bëj detyrën

Interpelanca e deputetit Erjon Braçe me ministrin e Financave Arben Ahmetaj, për kontrollin financiar në FSHF duket se ka 'ndarë' edhe deputetët socialistë me njëri-tjetrin. Ndërsa disa shpërthyen në të qeshura pas përfundimit të fjalës së socialistit Braçe, kolegu i tij, Bashkim Fino e ka duartkrokitur atë, ndërsa me tone kritike, siç duket edhe nga fotot e siguruar nga LSA, Fino i është drejtuar deputetëve me fjalët: "Mos qeshni po bëni detyrën". Nga karrigia e tij në sallën e seancave plenare, Fino nuk u kursye as ndaj ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati, ndërsa i kujtoi këtij të fundit akuzat e kryedemokratit Basha, dy ditë më parë. "Ti, Ditmir, mos qesh se nuk po flasim për financa, por për ato të tjerat, se ti asnjë votë nuk ke shtuar" - mësohet të jetë shprehur Fino. Dy ditë më parë kryetari i PD Basha në bashkëbisedimin me gazetaret tha: "Sigurisht për çështje zgjedhore, për çështje politike, por edhe për çështje të zgjedhjes së kryetarit të ri të Federatës së Futbollit, Ditmir Bushati ka angazhuar përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, sigurisht me porosi të Edi Ramës, për hesap të Bashkim Finos, krerët e bandës së Bajrajve. Këto janë fakte të denoncuar dhe të bëra publike"



macion për ligjshmërinë e FSHF-së, ndërsa përmendi disa emra futbollistësh dhe trajnerësh të famshëm botërorë, që nuk kishin paguar taksat në vendet në të cilat ushtronin aktivitetin dhe ishin dënuar. "Federata Shqiptare e Futbollit është një nga institucionet më të

rëndësishme në këtë vend, që përfaqëson flamurin e këtij vendi në aktivitetet ndërkombëtare. Që nga muaji shkurt kam kërkuar informacione për ligjshmërinë fiskale të tij dhe ende nuk kam një përgjigje të qartë", u shpreh Braçe. "Është emergjencë, FSHF-ja po avan-

Historia e Ulsi Manjës për pastrimin e listave të zgjedhjeve

Ndërsa ka diskutuar për ligjin e gjendjes civile, kreu i Komisionit të Ligjeve Ulsi Manja tha dje, se listat do të pastrohen nga personat që kanë ndërruar jetë, por që figuronjë ende në listat e zgjedhjeve, ndërsa tregoi një rast që shkaktoi të qeshura në sallë. "Ka 27 vite që regjistrat e Gjendjes Civile nuk pastrohen nga personat e vdekur dhe sa për humor, vajti një burrë 80 vjeç të votonte dhe pyeti një anëtar të komisionit, a votoi gruaja ime sot? Ai i tha po ka votuar në orën 08:30. Më raft pika, tha plaku, që nuk erdha të votoja më herët ta takoja. Pse i tha anëtar i komisionit, jeni të divorcuar, nuk jetoni bashkë? Jo, tha ai, ajo ka 30 vite që ka vdekur dhe të vetmen mundësi me e takuar është në zgjedhje se ajo vjen voton dhe ikën"-u shpreh Ulsi Manja.

con në këtë drejtim krahasuar me vitin 2014, por jemi ende larg formalizimit. Është e dukshme që sporti ka nevojë për mbështetjen e qeverisë dhe formalizim. Vetëm me formalizim i kthehet dinjiteti atyre lojtarëve që i trajtuam si heronj në Evropian", tha Ahmetaj.



Debat në parlament, FSHF: Braçe sillet në Kuvend si tifoz, në stadium si deputet

Federata Shqiptare e Futbollit reagoi dje, duke thënë se ka ndjekur me vëmendje zhvillimet në Kuvend. "FSHF, ashtu sikurse edhe UEFA dhe FIFA është veçanërisht sensitive, sidomos kur shikon tendenca nga ligjvënës, edhe pse të veçuar, që synojnë në thelb të cenojnë standardet ndërkombëtare të vendosura me kohë në këtë organizatë, dhe parësishme e saj nga politika. Sot, fatkeqësisht, si edhe disa herë të tjera, në mënyrë të përsëritur nga i njëjti deputet, por fatmirësisht për reputacionin e parlamentit shqiptar, i vetmi që në parlament sillet si tifoz i një ekipi, dhe në shkallët e stadiumit si ligjvënës, pamë jo vetëm gjuhë ofenduese por edhe kërcënuese, që në subkoshiençë fshihin ëndrrën e vjetër të një segmenti të caktuar të politikës për të pushtuar me dhunë FSHF-në", thuhet në reagimin e FSHF. "FSHF jo vetëm garanton transparencën e saj përballë organizimave ndaj të cilave është e detyruar në bazë të rregullave t'i përgjigjet, por inkurajoj, gjithashtu, punën e çdo institucioni shtetëror, apo qoftë dhe individit me pushtet, që në themel ka mirëfunksionim e kësaj organizate dhe jo ngritjen e ndonjë flamuri politik në ballkonet e saj. Duke rithekësuar besimin tonë tek institucionet e shtetit, nënvizojmë edhe njëherë se mesazhet e dala nga zëra të veçuar të politikës që baltosin jo vetëm imazhin e FSHF-së por edhe të UEFA-s do të përcillen dhe ndahen me të gjithë partnerët tanë në FIFA dhe UEFA", thuhet në deklaratën e FSHF.

Petrit Vasili: Parlamenti i uzurpuar, mazhoranca shkon për të ndarë paratë

Kryetari i grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili u shpreh dje, se bojkoti i opozitës do të vazhdojë, pasi, sipas tij, nuk është parlamenti i qytetarëve, por i uzurpuar nga opozita. "Kjo mazhorancë ka zgjedhur të 'hajë veten', pasi e ka të pamundur të bashkëjetojë politikisht me opozitën. Refuzon të marrë në shqyrtim nismat e opozitës. Mazhoranca miraton ligje të personalizuara, si ligji për teatrin, por për fat të mirë, presidenti e rrezoi. Një tjetër problematik është se në këtë parlament shkohet vetëm për të rindarë paratë e buxhetit. Ky është një qëndrim i qartë i yni. Sa kohë ka një parlament që imponon dhe uzurpon, nuk ka vend për ne. Nuk është parlamenti i qytetarëve dhe nuk ka vend për ne", - tha Vasili, në emisionin "Top Talk", në Top Channel. Sa i përket çështjes "Babale", ai u shpreh se është një moment demaskimi i mazhorancës, shumë i qartë. "Kjo është një mazhorancë e ndërtuar mbi trafikantët dhe ata po e denoncojnë", tha Vasili. Vasili, ndër të tjera, foli edhe për kauzën e opozitës për të rrezuar qeverinë e drejtuar nga Edi Rama. "Kauza e opozitës për të rrezuar Edi Ramën është shumë e qartë. Është një mazhorancë e inkriminuar deri në grykë. Që ta kuptojmë më mirë qytetarët duhet që të ja tregojmë me fakte dhe ngjarje konkrete. Ne e kemi bërë këtë. Pasi u denoncua çështja e "Babales", vëllai i deputetit shkoi në burg", - tha Vasili.



Nëse Kuvendi do ta rrezojë sërish dekretin e presidentit, atëherë ligji hyn në fuqi

Meta rikthen ligjin për Teatrin: Nuk garanton konkurrencën në garë

"Ligji shmang zgjidhjen e çështjes"

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta për herë të dytë riktheu dje për rishqyrtim në Kuvend ligjin për Teatrin Kombëtar, të miratuar për herë të dytë nga shumica parlamentare më 20 shtator që i hap rrugë prishjes së Teatrit Kombëtar. Në dekretin e tij, kreu i shtetit argumenton se pavarësisht amendimit të bërë nga socialistët në seancën e 20 shtatorit, ligji shkel parimet e barazisë përpara ligjit. Sipas presidentit: "Ligji shkel parimet e "barazisë përpara ligjit" dhe "lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve", parime këto që gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta; nuk është në harmoni me parimet themelore kushtetuese të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare, bie ndesh me parimet e Konventës Europiane të Trashëgimisë Kulturore Jo-materiale dhe cenon rëndë parimet kushtetuese të ndërtimit dhe funksionimit të organeve të pushtetit vendor të "decentralizimit" dhe "autonomisë vendore". Kreu i shtetit argumenton në dekretin e tij se edhe ligji i ri nuk zgjidh në thelb asnjë prej 9 çështjeve dhe problematikave kushtetuese e ligjore të evidentuara në dekretin e parë të presidentit. Kuvendi shprehet se presidenti megjithëse është përpjekur që të plotësojë vetëm 1 (një) prej konstatimeve kushtetuese që kishte të bënte me trajtimin preferencial dhe jo të barabartë të një subjekti privat, sërish me ligjin e ri Kuvendi rezulton se nuk ka arritur ta zgjidhë edhe këtë çështje. Z. Meta shprehet se në të paraqiten të njëjtat probleme kushtetuese, pasi edhe pse në pamje të parë duket sikur ka zgjidhur problematikën e konstatuar, në thelb dispozitat e tij përmbajnë kritere diskriminuese që nuk garantojnë konkurrencën e lirë, por përkundrazi, sërish konstatohet një trajtim preferencial që kufizon pjesëmarrjen në garë. "Duket sikur tashmë do të kemi një procedurë konkurrimi të lirë dhe që respekton kërkesat kushtetuese për veprimtari të lirë ekonomike dhe trajtim të barabartë, por, nëse shqyrtojmë dispozitat e mëtejshme ku përcaktohen kërkesat, mjetet dhe



Presidenti Ilir Meta

MIRATIMI
Ligji për Teatrin u miratua vetëm me votat e shumicës. Meta dekretoi dje kthimin e ligjit. Në argumentet e tij, kreu i shtetit vlerëson se ky ligj nuk ka arritur të zgjidhë në thelb asnjë prej 9 (nëntë) çështjeve dhe problematikave kushtetuese dhe ligjore të evidentuara në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 10849, datë 27.07.2018, edhe pse ky dekret rezultoi të jetë miratuar në tërësi nga Kuvendi.

ARTISTET

Artistët që prej muajit shkurt po protestojnë për mbrojtjen e dy teatrove kombëtarë kanë marshuar dje në mbërmje para kryeministrisë ku i kanë kërkuar Ramës të heqë dorë nga ligji. Artistëve protestues u janë bashkuar dhjetra qytetarë më pas i janë drejtuar presidencës për të falenderuar Metën që e ktheu për herë të dytë ligjin special. Ata janë shprehur se nuk heqin dorë.

SHKURTE

Meta riktheu ligjin për Teatrin, Balla: Do ta shqyrtojmë me qetësi dhe dashuri

Kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla reagoi dje pas kthimit sërish në Kuvend të ligjit për Teatrin Kombëtar, duke thënë se do të lexohet, shqyrtohet e më pas do të kalojë në seancë plenare. "Presidenti e ka njoftuar pa na e sjellë ne. Ne do ta lexojmë menjëherë dhe siç përcakton procedura e sanksionuar qartë në Kushtetutë dhe më pas për rolin që luan Kuvendi në shqyrtimin e dekretit do të shqyrtohet dhe do të kalojë në seancë plenare. Nuk ka ndodhur ndonjë gjë e madhe", tha Balla. Ai shtoi: "Ne jemi shumë seriozë në marrëdhënien me institucionin e Presidentit të Republikës dhe do ta shqyrtojmë me po aq seriozitet, me qetësi dhe dashuri gjithë propozimin që vjen nga Presidenti i Republikës".

Opozita bojkot Kuvendit, Kryemadhi një orë në zyrën e Bashës

Në një kohë kur bojkotuan edhe dje seancën plenare, vjen një lëvizje nga opozita. Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi shkoi paraditen e djeshme në selinë e PD-së për një takim me kryeopozitarin Lulzim Basha. Kryemadhi shoqërohej nga kreu i grupit të LSI-së Petrit Vasili dhe deputetja Klajda Gjoshja. Ndërkohë takimi në fjalë zgjati rreth një orë, ndërsa nuk pati asnjë deklaratë për mediat. Kujtojmë se prej ditësh situata politike në vend paraqitet e tensionuar, ku nga një anë "zien" çështja "Babalja" dhe nga ana tjetër "Xhisiela". Opozita ka sulmuar ashpër qeverinë "Rama" për lidhjet e saj me krimin, ndërsa kjo e fundit është kundërpërgjigjur me akuza.

"Pastrimi i parave", Tabaku: Indeksi i Baselit vendos alarmin

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, e ka vënë theksin sërish të çështjes e pastrimit të parave në vend. Ajo paraqiti disa dokumente me shifra të Indeksit të Baselit në një postim në rrjetin social 'Facebook'. "Ndërsa qeveria dhe mazhoranca akuzojnë në kor opozitën se e ka fajin për çdo të keqe që ndodh në këtë vend, Indeksi i Baselit, treguesi më zyrtar për pastrimin e parave, bëhet raporti i dytë ndërkombëtar që vendos alarmin se në Shqipëri po pastrohen paratë e krimin dhe të drogës", shkruan Tabaku.

"Teatri', Mustafaj: Meta po i jep shans qeverisë për reflektim

Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj shprehu dje bindjen se rikthimi i ligjit për Teatrin Kombëtar nga Presidenti Ilir Meta është një shans që kreu i shtetit po i jep mazhorancës që të tërhiqet nga projekti i saj. Teksa foli në rubrikën opinion në "News 24", Mustafaj u shpreh se vendimi i kreu të shtetit përmbush pritshmërinë e shumicës së opinionit publik në vend. "Presidenti Meta i ka dhënë dhe një shans tjetër qeverisë për të reflektuar. E përsëritës veprimin e Presidentit Meta", tha Mustafaj. Ish-ministri theksoi se kreu i shtetit nuk është



Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj shprehu dje bindjen se rikthimi i ligjit për Teatrin Kombëtar nga Presidenti Ilir Meta është një shans që kreu i shtetit po i jep mazhorancës që të tërhiqet nga projekti i saj.

kushte aspak të barabarta". Kuvendi sipas presidentit nuk ka shqyrtuar 8 nga 9 arsyet e dhëna prej tij në dekretin e mëparshëm, duke shmangur kështu zgjidhjen e çështjes dhe duke krijuar sërish një normë të re ligjore antikushtetuese. "Kuvendi ka votuar sërish një projekt të ri ligjor, të pajustifikuar dhe që në realitet nuk ofron asnjë zgjidhje për problematikat kushtetuese të konstatuara nga Presidenti i Republikës në dekretin e tij", argumenton kreu i shtetit. Në dekret Presidenti Meta argumenton se ligji i ri për Teatrin Kombëtar vjen në kundërshtim me standardet

të mbajë larg institucionin e Presidencës gjithë kësaj kohe. Presidenti Meta nuk është partizan politik, nuk jam nga ata që mendoj se Meta ka ruajtur këtë ligj për të nxjerrë inatet me Ramën. Meta prej kohësh është në pozicionin e tij institucional larg konflikteve", shprehet Besnik Mustafaj. Ai kritikoi dhe qëndrimin e mazhorancës lidhur me shembjen e Teatrit Kombëtar. Ai tha se kontrata mes qeverisë dhe firmës private është një marrëveshje okulte biznesi. "Qeveria dhe bashkia janë peng i një marrëveshje okulte me biznesin", deklaroi Mustafaj.

dhe vlerat e Bashkimit Evropian dhe parashikimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Sipas kreu të shtetit, ligji nuk mbështetet në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të plotë për tjetërsim dhe pronës publike, krahasuar me përfitimet ekonomike të shtetit shqiptar dhe interesin publik dhe në kushtet e mosfunksionimit të Gjykatës Kushtetuese, presidenti i kërkon Kuvendit ta marrë në rishqyrtim edhe këtë nismë të dytë të mazhorancës. Tani fjala i takon sërish Kuvendit. Nëse do ta rrezojë dekretin e presidentit, atëherë ligji do të hyjë në fuqi.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE G-JVQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.

ÇMIMI 3.850.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.11.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Në Ministerialin e Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM), që u zhvillua dje, në Beograd, zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, iu përgjigj flakë për flakë sekretarit të Shtetit të Ministrisë së Mbrojtjes së Serbisë, Bojan Jovic. Përfaqësuesi i Serbisë deklaroi se Serbia është kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës dhe Metohisë dhe e konsideroi të rrezikshme për stabilitetin në rajon shndërrimin e FSK-së në Forcë të Armatosur. Por ka reaguar menjëherë në fjalën e tij zëvendësministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, z.Petro Koçi, duke deklaruar se: "Kosova është një vend i pavarur që duhet të ftohet në SEDM.

Përfaqësuesi serb u shpreh kundër njohjes së Kosovës

Zv.ministri i Mbrojtjes, Koçi flakë për flakë me zyrtarin serb: Kosova, e pavarur

REAGIMI

Serbia është kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës dhe Metohisë dhe e konsideroi të rrezikshme për stabilitetin në rajon shndërrimin e FSK-së në Forcë të Armatosur. Por ka reaguar menjëherë në fjalën e tij zëvendësministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, z.Petro Koçi, duke deklaruar se: "Kosova është një vend i pavarur që duhet të ftohet në SEDM.

vend i pavarur që duhet të ftohet në SEDM. Anëtarësimi i Kosovës në iniciativë të tilla rajonale jo vetëm kon-

tribuan për paqen dhe stabilitetin në rajon, por lehtëson, gjithashtu, shpirtin e dialogut dhe realizmit mes

Prishtinës dhe Beogradit", tha zv.ministri i Mbrojtjes. Ndërkohë po dje, Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić i është kundërpërgjigjur anëtarit të zgjedhur të presidencës së Bosnjës, Zhejko Komšić, pas deklaratës së këtij të fundit se Kosova është shtet i pavarur. Teksa e ka cilësuar provokim për Serbinë, Dačić tha se Komšić ende nuk e ka marrë



Zëvendësministri i Mbrojtjes, z.Petro Koçi

detyrën e tij. Kryediplomati u shpreh se e konsideron Republikën Srpska shtet po aq të pavarur sa Kosova. Dačić i vuri në dukje Ko-

msiç faktin se ai mund ta konsiderojë personalisht Kosovën të pavarur; por ky nuk është qëndrimi i presidencës së Bosnjës.

Sot në Këlcyrë, ceremonia e varrimit të eshtrave të 573 ushtarëve grekë

Kryeparlamentari grek: Të përballojmë nacionalizmin e disa qarqeve në Shqipëri

"Jemi kundër krijimit të një 'boshti stabiliteti' në rajon"

Kryetari i parlamentit grek ka deklaruar se Athina po punon për të përballuar "dogmat nacionaliste të disa qarqeve në Shqipëri". Ky pohim përfshihet në reagimin e kryeparlamentarit grek ndaj propozimit të ministrit të Mbrojtjes Kammenos, për krijimin e një "boshti stabiliteti" në rajon, që do të shmangte veç të tjerash penetrimin e Rusisë në Ballkan. Sipas TV "Tribuna", kryetari i parlamentit grek, Nikos Voutsis, shprehu "befasimin dhe habinë" e tij ndaj propozimit të ministrit të Mbrojtjes. "Pres që (Kammenos) të japë shpjegime të mtejshme që të kuptojmë se çfarë do të thotë. Vlerësoj se ky është gabim nga çdo pikëpamje", tha kryeparlamentari grek dhe vazhdoi: "Në për vite të tëra po punojmë për bashkëpunimin dhe zhvillimin në Ballkan, hapjen e rrugëve për një pjesëmarrje të barasvlershme në BE. Jemi kundër krijimit të boshteve, pikërisht që të përballojmë qoftë dogmat dhe stereotipat nacionaliste nga ana e disa qarqeve në Shqipëri, qoftë penetrimin në Ballkan që orvatet kohë pas kohe të bëjë udhëheqja turke. Punojmë që të mos ekzistojnë dhe të mos krijohen boshte të tilla". Gjatë vizitës së tij në Uashington, ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kammenos diskutoi me nënsekretarin amerikan të Ahtetit, Wes Mitchell, idenë për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve fqinje, që do të shërbejë si barrierë ndaj rrezikut rus në Ballkan. Kammenos tha se në këtë mënyrë do të garantohet edhe stabiliteti i Maqedonisë, duke e shtyrë për të ardhmen zgjidhjen e mosmarrëveshjes për emrin mi-



Kryetari i parlamentit grek, Nikos Voutsis

dis Athinës dhe Shkupit. **ESHTRAT** Ndërkohë sot, në Këlcyrë do të zhvillohet një ceremoni fetare për varrimin e eshtrave të ushtarëve grekë të rënë gjatë luftës së viteve 1940-1941. Lajmi është

të konfirmuar nga Ministria e Jashtme greke, që nxori një komunikatë për shtyp mbrëmjen e të enjtes. "Në zbatim të marrëveshjes që u arrit me palën shqiptare dhe në kuadër të zgjidhjes së problemeve

shumëvjeçare ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, përfunduan punimet në zonën e Dragotit", thuhet në komunikatën e Ministrisë së Jashtme greke. Sipas komunikatës, të premtën në Këlcyrë do të zhvillohet cer-

REAGIMI

Ministria e jashtme greke "përsëritet edhe një herë tjetër bashkëpunimin miqësor me palën shqiptare në kuadër të marrëveshjes dhe shpreh kënaqësinë që thuajse 70-vjet pas flijimit të tyre, shpirtat e të rënëve grekë më në fund do të prehen në paqe", thuhet në deklaratën për shtyp të Ministrisë së Jashtme greke, një ditë para ceremonisë në Këlcyrë.

MARRREVESHJA

"Në zbatim të marrëveshjes që u arrit me palën shqiptare dhe në kuadër të zgjidhjes së problemeve shumëvjeçare ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, përfunduan punimet në zonën e Dragotit", thuhet në komunikatën e Ministrisë së Jashtme greke. Sipas komunikatës, të premtën në Këlcyrë do të zhvillohet ceremonia e varrimit të eshtrave të 573 ushtarëve grekë.

emonia e varrimit të eshtrave të 573 ushtarëve grekë. Më herët, në korrik, në varrezat e Bularatit i shkoi varrosur eshtrat e 100 të rënëve të tjerë. Punimet për kërkimin dhe varrimin e eshtrave do të vazhdojnë

në zonat e Kosinës, Këlcyrës dhe Përmetit, sipas vendimeve përkatëse të komisionit dypalësh të ekspertëve, njofton më tej ministria e jashtme greke. Në komunikatën për shtyp, njoftohet, gjithashtu, se më 28 tetor, do të zhvillohet një ceremoni përkujtimore për të rënë, ku do të marrin pjesë përfaqësues të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Greqisë. Ndërkaq, nuk thuhet se ku do të zhvillohet kjo ceremoni. Ministria e jashtme greke "përsëritet edhe një herë tjetër bashkëpunimin miqësor me palën shqiptare në kuadër të marrëveshjes dhe shpreh kënaqësinë që thuajse 70 vjet pas flijimit të tyre, shpirtat e të rënëve grekë më në fund do të prehen në paqe", përfundon komunikata për shtyp.

KOSOVA ANËTARËSOHET NË ORGANIZATËN NDERKOMBËTARE TË FRANKOFONISË



Rama me Thaçin takojnë Makron: Urime Kosovës, shtetit tonë të dytë

Kryeministri Edi Rama përgëzoi dje, Kosovën, e cila nga vëzhgueset u bë anëtare e asociuar e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë. "Kosova kalon sprovenë e miratimit dhe kthehet nga vëzhgueset në anëtar i asociuar i Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë. Urime Kosovës dhe të gjithë atyre që punuan për këtë votim me rëndësi për ecurinë e

shtetit tonë të dytë", thekson kryeministri Rama në një postim në Facebook. Në Erevan të Armenisë po zhvillohet samiti i 17-të i Frankofonisë, ku po merr pjesë krahas përfaqësuesve të mbi 80 shteteve të botës edhe kryeministri Edi Rama dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Të dy janë parë duke biseduar me presidentin e Francës, Emanuel Macron.

KPK nënvizoi se deklaratat për gjendjen cash dhe bankë ndër vite kishin pasaktësi

Prokurori Adnan Xholi para "vetingut"

ILDKPKI: Subjekti ka deklarim të saktë, ka burime të mjaftueshme financiare

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i udhëhequr nga Brunilda Bekteshi si kryesuese, Suela Zhegu relatore dhe Valbona Sanxhaktari anëtare, mbajti të enjten seancën dëgjimore për prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme Adnan Xholi.

Prokurori Xholi ka një karrierë 21 vjeçare në radhët e prokurorisë. Përpara se të emërohej në Prokurorinë e Përgjithshme në vitin 2013, ai ka punuar në Prokurorinë për Krime të Rënda.

Komisioni e ka ushtruar procesin e vetingut për subjektin për të tre kriteret e rivlerësimit, ku përfshihet pasuria, pastërtia e figurës dhe profesionalizmi. Në këtë kontekst KPK ka administruar raportet e përgatitura nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Reportet e shkruan se sipas ILDKPKI subjekti ka bërë deklaratim të saktë, ka burime të mjaftueshme financiare, nuk ka fsheje pasurie, nuk ka deklarim të rremë, dhe nuk ka konflikt interesi. DSIK ka konfirmuar se prokurori Xholi është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës, ndërkohë që grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme i ka dhënë një vlerësim me notën "shumë mirë" për sa i përket profesionalizmit.

Komisioni ka ndërmarrë një hetim të thelluar administrativ duke marrë në shtëpi pasuritë e deklaruara në deklaratat veting të vitit 2017, ku përfshihet një apartament 107 m² në Tiranë me vlerë 50 mijë euro, një automjet Benz' i vitit 2004 me vlerë 4 mijë euro, një tokë arë me sipërfaqe 22 mijë m², me pronësi 1/8 dhe likuiditet në banka dhe 'cash' me vlerë 2.5 milionë lekë.

Sipas KPK deklaratat e prokurorit Xholi në deklaratat veting për sa i përket apartamentit në Tiranë dhe automjetit përputhen me gjetjet e hetimit administrativ. Megjithatë, Komisioni nënvizoi se deklaratat për gjendjen cash dhe bankë ndër vite kishin pasaktësi,



Adnan Xholi, gjatë seancës së dëgjimore në KPK

ndërsa analiza financiare kishte treguar, gjithashtu, diferenca negative, për të cilat subjekti i është kaluar barra e provës.

Në fjalën e tij gjatë seancës dëgjimore, prokurori Xholi vlerësoi hetimin e "KPK-së si të thellë dhe objektiv", duke e përshkruar si një kontroll të "imtisishëm të jetës sime personale dhe familjare." Ai bëri një rezyme të shkurtër të karrierës së tij duke nënvizuar se kishte përfaqësuar akuzën në gjyq kundër grupeve kriminale të rrezikshme dhe kishte sekuestruar miliona euro pasuri të të ashtu-

quajturave 'Banda e Lushnjës' dhe Banka e Durrësit, si dhe të një kompanie batsh nën ndikim të 'Sacra Corona Unita' - mafia Puljeze.

Xholi tha se ishte dakord me gjetjen e KPK për sa i përket vlerësimit të pasurive të tij, por jo me analizën financiare për sa i përket likuiditetit. Xholi i tha Komisionit se eksperti financiar i KPK-së nuk kishte marrë parasysh që disa nga udhëtimet e tij jashtë shtetit të përllorogjiturat si shtepizime kishin qenë të mbuluara financiarisht nga shteti ose nga familjarët e tij.

KRIMI

Ngjarja e rëndë, 13-vjeçarja vritet me thikë në Babrru

Një vajzë 13-vjeçare dyshohet se është vrarë mbrëmë në afërsi të Babrrusë në Tiranë. Raportohet se e mitura, K.B., e ka marrë plagën në bark.

Ngjarja ka ndodhur në rrugën Niko Avrami pranë Bregut të Lumit në Tiranë. Ndërkohë mësohet se efektivi të kanë hasur vështrësi në marrjen në pyetje të prindërve të vajzës, pasi ata janë shurdh-memecë.

Babai i vajzës është shtetasi Xhevat Braha, ndërkohë janë shoqëruar në polici, babai, vëllai dhe nusja e këtij të fundit për të dëshmuar.

Nga ana tjetër, edhe mjekët e Spitalit Ushtarak e konfirmojnë që vajza ka shkuar me plagë në bark, por ende nuk e përcaktojnë nëse është plagë e shkaktuar nga armë zjarri apo nga mjete prerëse.

Gazetarja Dorjana Bezat raportoi për "Balkanweb" se minoranca ishte gjetur në agoni nga i ati Xhevat Braha që e kishte transportuar menjëherë në spital.

Mësohet se ajo kishte plagë me mjet prerës në trup dhe brenda pak minutash ka ndërruar jetë.



TERMS OF REFERENCE

Post Title: ICT Project Controller
 Duration of Assignment: 22 October 2018 to 31 December 2018, 12 days a month
 Project Name: Albanian Asylum Database Development
 Type of Contract: Individual Contract
 Educational Background: University Degree in Computer Sciences or equivalent
 Work Experience: At least 10 years of experience in developing and managing Web Applications.
 Tentative starting date: 22 October 2018

I - Background

The Office of the United Nations High Commissioner for Refugees in Albania provides its expertise and advice to the Government of Albania in all aspects related to the asylum system, in accordance with international law and standards, and to the dispositions of Albanian legislation, notably the Law on Asylum. This is done with the aim of having in place a sound asylum system and an environment in which refugees and asylum seekers can exercise their rights and fulfill their obligations as defined in the said legal bodies.

UNHCR will support Border and Migration Police and the Directorate of Asylum and Citizenship (DAC) in creating a database for managing the cases of all persons under the purview of the said Directorate. The project will consist in developing a Web Java Application that communicates with different State databases and Web Services.

Tendering has been launched and the awarded company will start developing and implementation the project on 20th October 2018.

In view of the above, UNHCR Albania is seeking the temporary services of an experienced national Project Controller to oversee the ongoing phases of the project on behalf of UNHCR.

II - Duties and Responsibilities

The main objective of the contractor will be to act as UNHCR focal point in ensuring that the project is carried out on time, within budget and following agreed BoQs. Under the overall supervision of the UNHCR Representative and the direct supervision of the UNHCR Associate Programme Officer, the main, but not exhaustive, duties and responsibilities of the incumbent will be the following:

1. Coordination with UNHCR

- Attend biweekly meetings (or more if necessary) in UNHCR offices;
- Inform UNHCR without delays of any difficulties in programme delivery, particularly on all issues that may increase costs or create delays in delivery;
- Act as the main focal point for UNHCR with all parties involved; as such be well informed about UNHCR requirements, rules and procedures;
- Inform UNHCR at once of any attempt by any side involved in the project to act in contravention to UNHCR rules and procedures;
- Provide technical guidance to UNHCR and suggest possible solutions in case of problems; and
- Provide UNHCR with weekly progress reports, highlighting potential and actual problems and suggesting solutions.

2. Service implementation and supervision

- Undertake twice-weekly inspections of the work in progress to determine if the services to be provided are proceeding in accordance with the development contract schedule, and that completed work conforms to the contract specifications;
- At the beginning of the development, agree on a clear work plan with the contractor software company with specific deadlines for each phase of the project (Note: the contract will specify penalty clauses for any delays in delivery from the contracted software company);
- Identify potential risks in delivery – in particular risks of delays/late completion and exceeding budget – and inform UNHCR immediately;
- Consider and evaluate requests for changes as proposed by the contractor(s) for modifications in design or specifications;
- Advise UNHCR on all matters concerning claims from the contractor and make recommendations thereon;
- Render written decisions within a reasonable time, on all claims, disputes and other matters in question relating to the execution or progress of work or the interpretation of the project contract documents;
- Report requests of the contractor to UNHCR and provide recommendations to UNHCR for approval when changes affect cost. Such changes shall be effected by written Work Orders issued by the Project Controller after obtaining UNHCR approval to such changes.
- For changes which do not affect cost or quality, approval may be granted on-site and recorded in the weekly progress reports.
- Liaise between the contractor and the beneficiary which is the Ministry of Interior, Directorate for Asylum in order to make sure that requirements are up to the institutional standards;

3 - Hand over

- Inspect the works in the presence of representatives of Contractor and beneficiary, Mol, prior to the handing over of any section of works;
- Prepare a final list of items to be completed, or replaced together with a time schedule for the remedying of the same in cooperation with beneficiary, Mol;
- Supervise the hand over process and make sure that final signature by Contractor and Beneficiary, Mol, Directorate for Asylum and Citizenship is obtained.

4 - Records

- Maintain orderly files for correspondence, reports of meetings, product and submissions, reproductions of original project contract documents including all addenda, variation orders, instructions, information and other documents issued subsequent to the start of contract;
- Keep a log book, recording data relative to questions of extras or deductions, decisions, observations in general;
- All specifications, reports, other documents and software prepared by the Project Controller shall become and remain property of UNHCR and the Project Controller shall deliver all such documents to UNHCR with a detailed inventory thereof.

5 - Reporting

The Project Controller shall prepare and submit weekly reports including the following:

- An updated assessment of progress and account of relevant developments;
- A summary of problems encountered and foreseen and solutions taken or to be taken;
- A brief presentation of actual versus planned progress; and
- Description of eventual additional work accepted with detailing dates of notification and subsequent actions and the time and cost effects as assessed;
- A Final Report – Summarizing and highlighting all major points of interest that arose during the implementation, the chronology of actions, problems encountered and solutions employed, changes made in contract and the reasons thereof, a breakdown of the final costs item by item, etc.

III - Deliverables

The Project Controller will provide the following deliverables in the format agreed to by the UNHCR Office:

- Work plan with clear deliverables and deadlines to be agreed with the contractor, Beneficiary (Mol) and UNHCR;
- Weekly monitoring reports on progress highlighting issues that require attention and action and a Final Report summarizing the above; and
- Certification Reports for each completed project in preparation for handover to Ministry of Interior, Directorate for Asylum and Citizenship.

IV - Key Competency Skills Required

- § Good knowledge and handling of project and program management methodology and techniques;
- § Good understanding of the wider objectives of the project;
- § Ability to work positively with the wide range of individuals involved in project management;
- § Strong leadership and management skills;
- § Good knowledge of budgeting and resource allocation procedures;
- § Ability to find innovative ways to resolve problems; and
- § Responding constructively to feedback.

V - Qualifications

- § University Degree in Computer Sciences or related discipline. Master's degree or similar post-graduate studies is an asset.
- § Security Certificate issued by DSIK
- § At least 10 years of experience in Software Developing and Management
- § Fully familiar with preparation and controlling of bidding documents and contract administration.
- § Practical experience of working with local administrations or elected authorities for planning and management projects;
- § Fluency in both written and spoken English and ability to communicate well is essential.
- § Previous experience/familiarity with UNHCR and/or other UN Agencies is an asset.

VI - Duration and Remuneration

The duration of this assignment will be from 22 October, 2018 to 31 December, 2018. The remuneration will be based on an estimated number of 12 days a month necessary to ensure the delivery of reports and monitoring of infrastructure implementation on a regular basis.

In accordance with UN rates for similar services, professional fees, will be paid upon satisfactory completion of the various defined tasks and acceptance of deliverables stated above by UNHCR Albania Office. As a payment pre-condition, monthly payment requests and invoices will be accompanied by a detailed report outlining the work completed during the payment period.

Interested candidates should read the Terms of Reference carefully and apply if suitably qualified. Candidates are required to submit signed Motivation Letter and UNHCR P11 form electronically by e-mail to: albt@unhcr.org or in a sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Str., Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania referring to the Terms of Reference UNHCR: ICT Project Controller. UNHCR P11 form and Supplement form are available: www.unhcr.org/refugees/p11new.doc (open Hyperlink). Only shortlisted candidates will be contacted;

Deadline for submitting applications is October 17th, 2018, 17:30 CET. Late or incomplete applications received without the above specified documents will not be considered;

BERAT - Administratorja e një qendre sociale në Berat është proceduar penalisht nga prokuroria, pasi akuzohet për korrupsion pasiv. Burime nga organi i akuzës bënë me dije dje për "Gazeta Shqiptare" se 50-vjeçarja Tatjana Toska akuzohet se ka kryer korrupsion, duke përfutur para nëpërmjet shpërdorimit të postit. Hetimet e



Merrte ryshfet në këmbim të një vendi pune, procedohet administratorja e qendrës sociale

prokurorisë nisën menjëherë pas daljes publike të ngjarjes në një nga emisionet investigative si dhe pas referimit të ngjarjes për hetim në këtë institucion nga sektori i hetimit dhe krimin ekonomik e financiar në Drejtorinë e Policisë

së Qarkut Berat disa ditë më parë. Ndërkaq, burime nga policia e Beratit pohuan nga ana e tyre janë kryer të gjitha veprimet procedurale, nga të cilat ka rezultuar se Toska duke ushtruar detyrën e administratorës së qendrës sociale

në këtë qytet, gjatë periudhës janar-shkurt të këtij viti dyshohet se ka përvetësuar shumën prej 200.000 lekësh. Kjo vetëm për të punësuar pranë kësaj qendre 49-vjeçarin Agron M., banues në lagjen "Dëshmorët e Kombit" në Berat. Gjithashtu,

dyshohet se ajo ka përvetësuar edhe shumën prej 300.000 lekësh, duke i premtuar një vend pune për bashkëshorten një shtetasi tjetër G.S., banues në lagjen "Donika Kastrioti" në Berat. Materialet në ngarkim të 50-vjeçares i kanë kaluar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për veprat penale "Korrupsion pasiv në sektorin privat" dhe "Mashtrimi".

"I çmontuam vullnetarisht, edhe pse investuam për 20 vjet. Shteti po na bën gropën"

IKMT nis aksionin për pastrimin e "Syrit të Kaltër" nga lokalet pa leje

Pronarët shpërthejnë lot: I kemi me dokumente të rregullta, na njoftuan një ditë para se të ndërhynin

Arbër Sulo

SARANDË

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka nisur mëngjesin e djeshëm një aksion për prishjen e dy godinave, të cilat shërbenin si lokale shërbimi në pikën turistike të "Syrit të Kaltër" në bashkinë e Finiqit, i cili prej vitesh është shpallur Monument Natyre. Mësohet se dy lokalet prej druri kishin vite që funksiononin në këtë zonë. Në mbështetje të aksionit të IKMT-së kanë qenë edhe forcat policore. Aksioni në fjalë ka irrituar pronarët, të cilët kanë deklaruar se janë njoftuar dy ditë më parë dhe se objektet i kanë me dokumente të rregullta. Pavarësisht se deklaruan se shteti po i gropos për së gjalli, ata kanë nisur të çmontojnë vullnetarisht objektet.

REAGIMI I PRONARËVE

Të afërm të pronarit të lokalit të parë "Blue Eye", i cili ndodhet në hyrje të pikës turistike u shprehën se janë të rregullt me shtetin dhe të kompletuar me dokumentacionin përkatës. Sipas tyre, kontrata e lidhur skadon në vitin 2023. Megjithatë priten ca kohë, pasi nuk besonin ende se lokali do të shembej, ata nisën ta çmontonin vetë objektin. "Nuk jemi pa leje, jemi të pajisur me gjithë dokumentacionin e duhur", tha i irrituar një i afërm i pronarit të lokalit në fjalë. Të njëjtën gjë deklaroi dhe nipi i pronarit. Ndërsa, te lokali i dytë çmontimi kish të nisur që herët. Pronari i këtij lokalit, Fatmir Gjoka tha i përlotur: "Kam 20 vjet që e kam ngritur nga hiçi këtë lokal. Nuk di se çfarë të bëj. Shteti është shtet. Na propozi. Këto janë lot burri. Ta shohë dhe kryeministri se çfarë bëjnë. Na lajmëruan 24 orë më parë. Çfarë të bëjmë, nuk e di. Kam 20 vjet që operoj me taksa, jam i rregullt dhe sipas ligjeve të shtetit tim. Kam 20 familje që ushqehen me punën që bëjnë këtu në biznesin tim. Nuk kam asnjë informacion se çfarë do të bëhet këtu. Liroje vendin më thanë pasditën e së mërkurës. I lutem shtetit të gjykojë me drejtësi.



Pronarët duke çmontuar vullnetarisht lokalet



Fatmir Gjoka duke folur për "GSH"

si. Nuk kërkoj lëmshë. Kam nisur ta çmontoj vetë. Nuk e marr vesh kush ia ka vënë syrin vendit ku është lokali im. Nuk e di a është ndonjë lupo, apo ka dhënë ndonjë lekë nuk e di. Unë kam një kontratë me 'Alb-turizmin', me Ministrinë e Kulturës. I kam njoftuar dhe nuk më kanë kthyer përgjigje". Ndërkaq, Gjoka tha se aty afër është ngritur edhe një kioskë. "Kjo kioska këtu u ngrit para një viti.

Nuk e di e kujt është dhënë si hapet rrugë asaj. Mbaruan zgjedhjet më 27 qershor dhe në 28 e sollën kioskën dhe ngulën me vinq këtu. Më 31 janar të 2019-ës mbush plot 20 vjet këtu tek ky vend. Vendi këtu ka qenë një përrua. Unë e kam sjellë korrentin nga 2 km se nuk kishte korrent këtu. Vura në efikasitet fshatin e vogël turistik. Kam mbjellë shumë pemë. Edhe rrugën deri këtu e kam bërë vetë dhe të kem

këtë përfundim, të më hëdhin si leckë, nuk e kuptoj". Nga ana tjetër, avokati mbrojtës, Flamur Laze u shpreh se ndërhyrja e IKMT tek objektet e klientëve të tij është e padrejtë. "Nuk janë të njoftuar për prishjen. Ata janë të pajisur me dokumentacionin përkatës. Nuk duhej nisur nga prishja, nga sinjalizimi fillimisht që t'u jepej kohë qytetarëve, pronarë të këtyre objekteve të kërkonin të drejtën e tyre me rrugë ligjore. Ata janë të rregullt me dokumentacionin sipas kontratës së lidhur me institucionet përkatëse", tha avokati Laze.



DEKLARATA

Avokati mbrojtës, Flamur Laze u shpreh se ndërhyrja e IKMT tek objektet e klientëve të tij është e padrejtë. "Nuk janë të njoftuar për prishjen. Ata janë të pajisur me dokumentacionin përkatës. Nuk duhej nisur nga prishja, nga sinjalizimi fillimisht që t'u jepej kohë qytetarëve, pronarë të këtyre objekteve të kërkonin të drejtën e tyre me rrugë ligjore. Ata janë të rregullt me dokumentacionin sipas kontratës së lidhur me institucionet përkatëse", tha avokati Laze.

me rrugë ligjore. Ata janë të rregullt me dokumentacionin sipas kontratës së lidhur me institucionet përkatëse", tha avokati Laze. Deri në orën 16:00 të ditës së djeshme, IKMT nuk kishte ndërhyrë për të prishur objektet, ndërsa ishin në pritje të çmontimit të tyre nga vetë pronarët. Kur gjithçka të çmontohet prej pronarëve, atëherë IKMT do të ndërhyjë për të prishur platformat dhe bazamentet prej betoni.



Sekuestrohen drogë, armë dhe municione luftarake, kapet 37-vjeçari në kërkim

FIER - Policia dhe FNSH-ja e Fierit vijojnë kontrollet në lokale, rrugë e ambiente të ndryshme në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Gjatë kontrolleve të ushtruara ditën e djeshme, u sekuestrua një sasi droge, armë dhe municione luftarake, ndërsa u shoqëruan për verifikim 11 persona kryesisht me precedent penal të dyshuar për "Armëmbajtje pa leje" dhe për "Vjedhje". Ndërkaq, mësohet se gjatë kontrollit në një lokal në fshatin Zhupan u kap me armë zjarri shtetasi Aleksandër Hoxhaj, i cili ishte shpallur në kërkim për veprën penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave". Sapo ka parë policinë të hyj në lokal, 37-vjeçari Hoxhaj ka hequr armën nga brezi dhe e ka hedhur nga dritarja e lokalit, por falë veprimeve të shpejta të policisë u konstatua veprimi i tij dhe u arrestua në flagrancë. Sipas bluve, gjatë kontrollit të banesës së tij u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 15 paketime me lëndë narkotike e dyshuar kanabis sativa me peshë 43.5 kg dhe 3 dokumente të falsifikuara: pasaportë, kartë identiteti dhe leje drejtimi automjeti në gjuhën greke me foto të këtij shtetasi. Gjithashtu, u sekuestruan sende të ndryshme të dyshuara që përdoren për kryerjen e vjedhjeve: 2 matrapikë, 2 leva metalike, 1 maskë me ngjyrë të zezë, 1 palë dorashka, 1 tub metalik që shërben për hapjen e dyerve, 1 pincë etj., sende që dyshohen se i ka vjedhur: 3 kompjuterë lap-top dhe 1 kasafortë metalike dhe 34 fishekë pistolette dhe automatiku. Sipas bluve, kontrollet do vijojnë në gjithë Qarkun e Fierit për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë, me qëllim rritjen e parametrevë të sigurisë.

Policia: Konflikti pas sherrit kush je ti e kush jam unë. Trondit dëshmitari

Masakër në Mat, vriten me kallashnikov 3 punonjësit e bashkisë e plagoset 1 tjetër

U qëlluan në lokalin e fshatit teksa po hanin bukë. 40 efektivë arrestuan pas 2 orësh kryeplakun, Kujtim Koxha

Enver Doçi

MAT

Tronditet Mati dhe jo vetëm. Tre punonjësit e bashkisë janë vrarë, ndërsa është plagosur kolegu i tyre. Mësohet se viktimat kanë qenë duke drekuar, pasi kishin punuar për ndërtimin e një rruge, kur janë qëlluar me breshëri kallashnikovi nga Kujtim Koxha. Ngjarja e rëndë ku humbën jetën Mentor Hoxha 36 vjeç, Erzen Aliaj 49 vjeç dhe Hamit Buçi si dhe mbeti i plagosur, Astrit Hani 40 vjeç, ndodhi pasditen e djeshme në fshatin Shëlli të njësisë administrative Lis, pas një konflikti mes 51-vjeçarit Koxha, kryeplak i fshatit në fjalë dhe punonjësit të bashkisë së Matit. Menjë herë në vendngjarje kanë mbërritur forca të shumta policore, të cilat janë vënë në kërkim të autorit të krimit. Pas dy orësh kërkime është bërë e mundur arrestimi i autorit të masakrës, Kujtim Koxha, ish-kryetar i Partisë Socialiste në fshatin Shëlli i kap rreth një orë larg vendit ku ndodhi vrasja e trefishtë dhe konkretisht në një urë, në afërsi të fshatit Burgajet. Ndërkaq, ende nuk dihet saktësisht motivi i krimit. Burimet nga policia, Bashkia e Matit dhe banorët e zonës janë kontradiktore. Pas kryerjes së hetimeve paraprake hetimore në vendin e ngjarjes, burime nga policia bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se kryeplaku iu kishte kërkuar punonjësit të Bashkisë t'i çonin rrugën deri tek shtëpia e tij, por ata nuk kishin pranuar i janë përgjigjur se kishin një projekt para, të cilin duhet të zbatonin që me sa duket nuk e parashikonte rrugën deri te shtëpia e kryeplakut. Ndërsa, burime të tjera po nga policia pohuan se gjithçka ndodhi pas një sherrit banal. Sipas këtyre burimeve, autori i masakrës dhe punonjësit e bashkisë e kanë nisur sherrin siç ndodh rëndom në Shqipëri: Kush je ti e kush jam unë; kush është i "fortë". Banorët të zonës thanë se konflikti mes palëve nuk ka qenë për rrugën dhe se agresori ka qenë i dehur. Do të jenë hetimet e mëtejshme që do të hedhin dritë mbi ngjarjen që shokoi gjithë vendin. Përveç hetimeve intensive, policia ka marrë në mbrojtje familjen e autorit të vrasjes së trefishtë, pasi i druhen një hakmarrje të mundshme nga të afërmit e viktimave.

MASAKRA

Prej katër ditësh, punonjësit e bashkisë së Matit: Mentor Hoxha, Erzen Aliaj, Hamit Buçi dhe Astrit Hani ishin duke punuar për rikonstruktimin e rrugës së fshatit Shëlli që lidhet me fshatra të tjerë të njësisë administrative të Lisit. Mëso-



Lokali ku ndodhi masakra



51-vjeçari i arrestuar, Kujtim Koxha

TË VRARË

1. Mentor Hoxha 36 vjeç
 2. Erzen Aliaj 49 vjeç
 3. Hamit Buçi
- I PLAGOSUR
- Astrit Hani 40 vjeç,

Vrasja e trefishtë në Mat, Basha: Shteti ka degraduar

TIRANË - Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka reaguar pas ngjarjes së rëndë në Mat, ku mbetën të vrarë tre punonjësit e bashkisë. Kryedemokrati tha se ngjarja e tmerrshme ka trazuar shpirtin e çdo shqiptari, ndërsa u shprehu ngushëllimet familjeve të tre viktimave. Basha shkruan në "Facebook" se ngjarja është një tjetër dëshmi e degradimit total të shtetit. "Një ngjarje e tmerrshme ka goditur sot Matin dhe ka trazuar shpirtin e çdo shqiptari. Tre punonjësit të bashkisë që po punonin për ndërtimin e një rruge janë vrarë barbarisht me bukë në gojë në fshatin Shëlli. Në këto momente të vështira jam pranë familjeve të Mentor Hoxhës, Hamit Buçit dhe Erzen Aliajës dhe lus Zotin që t'ua lehtësoj sado pak dhimbjen Po ashtu i utoj shërim të shpejtë të plagosurit Astrit Hani. Ngjarja e sotme është një tjetër dëshmi e përgjakshme e degradimit total të shtetit, e pasigurisë që mbretëron ngado dhe e guximit të banditëve të veshur me pushtet për të kryer një masakër të tillë".



Bashkia, tituj nderi 3 të vrarëve, sot ditë zie

Masakra, kryebashkiaku i Matit: më thanë "na vranë duke ngrënë bukë"

MAT - Kryetari i Bashkisë së Matit, Nezir Rizvani ka folur për ngjarjen e rëndë të ndodhur dje në fshatin Shëlli. Në një prononcim për "News24" dhe "Gazeta Shqiptare", Rizvani tregoi për telefonatën e fundit me brigadierin. "Për ngjarjen më njoftoi brigadieri në telefon. Ai më tha që 'ishim duke ngrënë bukë, ai erdhi dhe na vrau pothuajse të gjithëve. Mora shënim e Komisarariatit dhe shkova menjëherë në vendngjarje. Kishin 4 ditë që punonin. Nuk besoj se konflikti ka ndodhur për rrugën. Sipas dëshmitarëve, autori ka qenë i dehur", ka thënë kryebashkiaku Rizvani. Pas



masakrës është bërë mbledhja e këshillit bashkiak të Matit. Bashkiakët iu kanë dhënë titullin "Nderi i Bashkisë" pas vdekjes 3 punonjësit që mbetën të vrarë. Gjatë mbledhjes u kërkuua nga kryetari i këshillit bashkiak të Matit që tre punon-

jësit të shpallen dëshmorë. Ndërkaq, bashkia ka shpallur të premtën ditë zie dhe flamuri i bashkisë do të ulet në gjysmë shtize. Mësohet se bashkia ka marrë përsipër shpenzimet e ceremonive mortore të tri viktimave.

MOTIVI I KRIMIT

Ende nuk dihet saktësisht motivi i krimit. Burimet nga policia, Bashkia e Matit dhe banorët e zonës janë kontradiktore. Burime nga policia bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se kryeplaku iu kishte kërkuar punonjësit të bashkisë t'i çonin rrugën deri tek shtëpia e tij, por ata nuk kishin pranuar. Ndërsa, burime të tjera po nga policia pohuan se gjithçka ndodhi pas një sherrit banal. Sipas këtyre burimeve, autori i masakrës dhe punonjësit e bashkisë e kanë nisur sherrin siç ndodh rëndom në Shqipëri: Kush je ti e kush jam unë; kush është më i fortë. Banorët të zonës thanë se konflikti mes palëve nuk ka qenë për rrugën dhe se agresori ka qenë i dehur.

het se paraditen e djeshme, ata kanë debatuar me kryeplakun e fshatit, Kujtim Koxha. Rreth orës s 14:00, punonjësit e bashkisë së Matit kanë shkuar për të drekuar në lokalin e fshatit. E ndërsa, ishte shtruar dreka dhe kishin nisur të hanin, ka hyrë i armatosur

në lokal 51-vjeçari Koxha. Ky i fundit ka qëlluar me breshëri kallashnikovi në drejtim të tavolinës ku ndodheshin punonjësit e bashkisë. Për pasojë ka mbetur i vdekur në vend Mentor Hoxha, ndërsa tre kolegët e tij kanë mbetur të plagosur. Erzen Aliaj dhe

Hamit Buçi kanë ndërruar jetë dy orë më pas në spitalin e Traumës në Tiranë. Ndërkohë, që i plagosuri Astrit Hani, banor i fshatit Shëlli, ndodhet në burgun e Burrelit jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se tre të vrarët janë nga fshatra të ndryshëm të njësisë admin-

istrative të Lisit. Vrasja e trefishtë ka alarmuar policinë, e cila ka mbërritur shpejt në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. 40 efektivë janë vënë në ndjekje të autorit të krimit, i cili ishte larguar nga vendi i ngjarjes me një motor në rrugën e vjetër që lidh Matin me Dibërën. 51-vjeçari Kujtim Koxha u prangos pas dy orësh në afërsi të fshatit Burgajet.

DËSHMITARI

Pak orë pas masakrës, janë zbuluar detaje të tjera të frikshme. Mësohet se ngjarja mund të kishte pasur dhe më shumë viktime. Sipas dëshmitarëve, Kujtim Koxha ka hyrë në lokal më

një kallashnikov dhe dy karikatorë. Njërin e kishte në armë dhe tjetrin në xhep. Në momentin që ka qëlluar me breshëri në drejtim të tavolinës ku ishin punonjësit e bashkisë, ka hyrë një person në lokal. Ai i ka kapur nga pas automatikun Koxhajt dhe ia ka ngritur lart. Nëse nuk do i kishte kapur armën, asnjë nuk do ishte gjallë. Ai na shpëtoi", tha dje një dëshmitar për "Gazeta Shqiptare". Ndërsa, mësohet se në lokal, në momentin e ngjarjes ndodheshin gjithsej 7 persona, pjesa më e madhe punonjësit të Bashkisë së Matit.

Aksioni do të vijojë në të gjithë vendin

115 farmaci kalojnë në "sitë", masa për shkelje ndaj 56 subjekteve

Janë intensifikuar kontrollat në rrjetin e hapur farmaceutik për tregtimin e barnave pa recetë. Që nga krijimi i Task Forcës së ngritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, 1 muaj më parë, janë kontrolluar 115 farmaci në të gjithë vendin. Kontrollat kanë qenë të fokusuar kryesisht te plotësimi i kushteve të ruajtjes dhe monitorimit të barnave, të kushteve higjieno-sanitare, kontrollin e barnave mbi pullën e sigurisë, kontrollin për

KONTROLLI

Gjatë kontrollit të farmacive janë konstatuar disa shkelje, për të cilat janë marrë 56 masa për shkelje administrative, prej të cilave, 20 masa për tregtim të barnave pa recetë, 18 masa për mungesë të recetave sipas klasifikimit, 13 masa për tregtim të barnave pa pullë dhe 5 masa për subjektet për mosrespektim të kushteve të ruajtjes së barnave

tregtimin e barnave pa recetë e mjekut. Gjatë kontrollit të farmacive janë konstatuar disa shkelje, për të cilat janë marrë 56 masa për shkelje administrative, prej të cilave, 20 masa për tregtim të barnave pa recetë, 18

masa për mungesë të recetave sipas klasifikimit, 13 masa për tregtim të barnave pa pullë dhe 5 masa për subjektet për mosrespektim të kushteve të ruajtjes së barnave. Task-Forca për kontrollin e barnave, është e

përbërë nga përfaqësues të disa institucioneve, ku përfshihen për herë të parë edhe inspektorë të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, që do të ushtrojnë kontrollin në çdo subjekt farmaceutik. Kontrollat do të shtrihen në



të gjithë vendin, me qëllim garantimin e sigurisë së tregtimit të barnave për qytetarët në të gjithë vendin. Disa ditë më parë, në kuadër të Platformës së Bashkëqeverisjes, ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu

ka deklaruar se, nuk do të ketë asnjë tolerim për farmacistët dhe farmacitë që japin ilaçe pa recetë. E për këtë është ngritur një task-forcë, e cila do të inspektojë kushtet e tregtimit të barnave dhe shitjen e tyre në farmaci.

Shtesa në udhëzimin e MASR/ Raundi i tretë, 18 tetori afati i fundit i konkurrimit

Gara në universitete s'ka përfunduar, mundësia e fundit për maturantët

Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për të aplikuar

Të gjithë ata maturantët që nuk kanë mundur dot të aplikojnë në raundin e parë dhe të dytë në një nga programet e studimit për vitin e ri akademik 2018-2019, mund të shfrytëzojnë edhe një mundësi të fundit. Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë përmes një shtese që ka bërë në udhëzimin nr.18 të datës 21.5.2018 ka vendosur t'u japë një shans atyre që s'kanë mundur të bëhen ende pjesë e universiteteve. "Në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar, pas pikës 1, të kreut IV, "Raundi i tretë", të shtohet pika 1/1, me përmbajtjen si më poshtë: "1.1 Për maturantët që nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë dhe në raundin e dytë, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe respektojnë kriterin e notës mesatare, sipas vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, mund të bëhen pjesë e raundit të tretë, pasi të kenë aplikuar në portalin U-Albania, duke ndjekur procedurën e parashikuar në pikën 5, germa A, kreu III, të këtij udhëzimi. Kjo procedurë të kryhet brenda datës 18 tetor 2018, pasi të jetë kryer më parë konfirmimi në portalin U-Albania nga institucionet e arsimit të lartë, ku këta maturantë janë të interesuar të studiojnë.", - theksohet në udhëzim. Për zbatimin e këtij udhëzimi janë ngarkuar Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit të lartë. Ky udhëzim ka hyrë në fuqi ditën e djeshme, menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



RAUNDI I TRETË
Të gjithë ata kandidatë që kanë aplikuar në një prej degëve të studimit në universitetet në raundin e dytë, kanë pasur mundësi të regjistrohen pranë sekretarive mësimore në datat 9-13 tetor të këtij viti.

Sakaq, aplikantët që nuk janë shpallur fitues as në Raundin e parë, as në Raundin e dytë, mund të riaplikojnë sërish në afatin kohor 15-18 tetor 2018. Ndërkohë, regjistrimi i kandidatëve të miratuar në sekretariatet mësimore do të bëhet në 19 dhe 20 tetor për t'i dhënë fund

kështu procesit të aplikimit dhe regjistrimit në universitetet për vitin e ri akademik 2018-2019. Çdo raund do të përbëhet nga 7 faza 48-orëshe secila. "Përzgjedhja e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të studimeve me karakter profesional, si dhe pro-

AFATI
"Kjo procedurë të kryhet brenda datës 18 tetor 2018, pasi të jetë kryer më parë konfirmimi në portalin U-Albania nga institucionet e arsimit të lartë, ku këta maturantë janë të interesuar të studiojnë", - theksohet në udhëzim.

KRITERET
Për maturantët që nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë dhe në raundin e dytë, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe respektojnë kriterin e notës mesatare, mund të bëhen pjesë e raundit të tretë, pasi të kenë aplikuar në portalin U-Albania.

grameve të integruara të studimeve të ciklit të dytë të ofruara nga IAL-të për vitin akademik 2018-2019, të bëhet në portalin eaplikimit universitar U-Albania. Maturantët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk

kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare. Kandidatët zgjedhin deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të publike/ jopublike, për vitin akademik 2018-2019", - thuhet në udhëzim.

Nis samiti i parë i vajzave në Shqipëri/ Synimi, pjesëmarrja e vajzave në vendimmarrje

ja e Aleancës së Grave deputete, Elona Gjëbrea u shpreh se politika ka nevojë për pjesëmarrjen dhe vizionin e të rinjve. Fushata Girl2Leader, do të mirëpresë mbi 1.500 vajza në aktivitete që zhvillohen në Shqipëri, SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Bolivi, Kanada, Guine, Irlandë, Kenia, Liberi, Malajzi, Monako, Poloni, Rumania,

Ruanë dhe Ukrainë, etj. Në Shqipëri, deputetet Dhurata Çupi Tylli, Elona Gjëbrea, Ogerta Manastirliu, Oriola Pampuri, Nora Malaj, Rudina Hajdari, Klajda Gjoshja dhe Elisa Spiropali do të mirëpresin rreth 22 vajza të reja të moshave nga 15-21 vjeç, si pjesë e fushatës globale, e cila zhvillohet në pesë kontinente, drejtohet nga Forumi Global

i Grave në Politikë (WPL) dhe që synon të inkurajojë vajzat adoleshente që të marrin në konsideratë pjesëmarrjen e tyre në vendim-marrje. Fushata është një mundësi e mirë për vajzat që të dëgjojnë histori frymëzuese të politikaneve gra, të mësojnë nga ekspertecat e tyre në politikë dhe në vendimmarrje.



DV-2020 UDHEZIMI

Voltiza Duro

Deri në 6 nëntor të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në Shtetet e Bashkuara mund të aplikojnë për lotarinë amerikane. Departamenti Amerikan i Shtetit thekson se aplikantët duhet të paraqesin informacionin e kërkuar në mënyrë që regjistrimi në DV-2020 të jetë i suksesshëm. "Ju duhet të paraqisni informacionin e mëposhtëm për të plotësuar regjistrimin tuaj E-DV: emrin - mbiemrin, emrin, emrin e mesit - ekzaktesisht siç shkruhet në pasaportë. Tek emri i mesit do të klikoni kutinë: 'no middle name'. Datën e lindjes - ditë, muaj, vit. Gjininë - mashkull ose femër. Qytetin e lindjes", - nënvizohet në udhëzim. Në këtë të fundit bëhet me dije se aplikantët duhet të plotësojnë informacionin edhe mbi shtetin e lindjes ku duhet të përdorin emrin me të cilin njihet aktualisht shteti ku kanë lindur. Përsa i përket pyetjeve mbi vendin e kualifikueshëm për programin e lotarisë, aplikantët që kanë lindur në Shqipëri, nuk ka nevojë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Vendi i kualifikueshëm për programin e lotarisë normalisht do të jetë i njëjti me atë të lindjes. Vendi i kualifikueshëm për programin e lotarisë nuk lidhet me vendin ku aplikuesi jeton.

FOTOGRAFITË

Fotografitë e të regjistruarve duhet të jenë foto personale pa syze, të nxjerrë 6 muajt e fundit, për aplikantin kryesor; të bashkëshortit/es, si dhe të të gjithë fëmijëve të përfshirë në regjistrim. "Nuk është e nevojshme të përfshini një foto të bashkëshortes/it dhe fëmijëve, tashmë qytetarë amerikanë ose rezidentë të përhershëm të ligjshëm (me green card), por në rast se i përfshini, nuk do të ketë pasojë në aplikimin tuaj për vizë shumëllojshmërie. Fotografitë në grup nuk do të pranohen, duhet të paraqisni nga një fotografi për çdo individ. Regjistrimi juaj mund të skualifikohet ose viza juaj të refuzohet nëse fotografitë tuaja nuk janë të kohëve të fundit, janë të manipuluar në një formë apo në tjetrën, ose nuk respektojnë specifikimet e mëposhtme. Nëse përfshini fotografi që e kishit përdorur në regjistrimin e vitit të kaluar (DV-2019), ju do të skualifikoheni automatikisht, ndaj përdorni fotografi të nxjerrë kohët e fundit", - theksohet në njoftim.

TË DHËNA TË TJERA

Gjithashtu, në pikën e tetë të pyetjeve, kandidatët duhet të vendosin saktë adresën postare, ndërsa në pikën 9, shtetin ku aplikanti jeton aktualisht. Më tej të interesuarit duhet të plotësojnë informacionin mbi numrin e telefonit; adresën e e-mailit (një adresë poste elektronike (e-mail) në të cilën aplikanti ka akses të drejtëpërdrejtë). "Nëse aplikimi juaj përzgjedhet dhe ju i përgjigjen njoftimit të përzgjedhjes tuaj nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarit, ju do të merrni e-maile të tjera komunikuese nga Departamenti i Shtetit duke ju njoftuar që informacioni me detaje i intervistës për vizën emigruese është vendosur në Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve. Departamenti i Shtetit kurrë nuk do t'ju dërgojë një e-mail duke ju thënë se ju jeni përzgjedhur për programin e DV-së", - thekson Departamenti Amerikan i Shtetit.

NIVELI I ARSIMIMIT

Në sektorin e nivelit arsimor kandidatët duhet të japin të gjithë informacionin lidhur me nivelin më të lartë të arsimimit që kanë arritur deri më sot. Alternativat që jepen janë: vetëm shkollë fillore, disa vite shkollë të mesme, pa diplomë; diploma e shkollës së mesme; shkollë profesionale; disa kurse universiteti; diplomë universitare; disa nivele të kurseve pasuniversitare; master; disa kurse të doktoraturës; si dhe doktoraturë.

Departamenti Amerikan i Shtetit: Jepni informacionin e plotë mbi arsimimin e statusin martesor

Lotaria amerikane, si të plotësoni saktë formularin elektronik

"Kujdes, ja në cilat raste mund të penalizoheni"



KËSHILLA MBI APLIKIMIN E LOTARISË AMERIKANE:

- 1-Lexoni rregullat dhe aplikoni vetëm nëse plotësoni kushtet.
- 2-Aplikoni vetëm një herë, përfshini bashkëshortët dhe fëmijët nën 21 vjeç (bashkëshortët mund të aplikojnë më vete).
- 3-Sigurohuni që foto është e saktë (kontrolloni përmasat, sfondin dhe hiqni syzet).
- 4-Kontrolloni mirë të dhënat (ju jeni përgjegjës për të dhënat që jepni, kontrolloni punën e ndihmësve dhe përkatësitë).
- 5-Aplikimi është falas (ju nuk keni nevojë të paguani askënd për të aplikuar).

STATUSI AKTUAL MARTESOR

Të gjithë ata që do të bëjnë regjistrimin e DV-2020 duhet të plotësojnë edhe informacionin mbi statusin aktual martesor si: i/e pamartuar; i/e martuar dhe bashkëshorti/ja ime nuk është qytetarë amerikanë, apo me (green card); i/e martuar dhe bashkëshorti/ja ime është qytetarë amerikanë, ose me (green card); i divorcuar; i ve, ose i ndarë ligjshëm. "Vendosni emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes, shtetin e lindjes së bashkëshortit/es tuaj dhe një fotografi të bashkëshortit tuaj që plotëson specifikimet teknike të njëjta si fotoja juaj. Mosvendosja e bashkëshortit/es tuaj në regjistrimin tuaj për lotarinë, ose vendosja e ndokujt që nuk është bashkëshorti/ja e juaj në ditën që po dorëzoni regjistrimin për

lotarinë, do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit kryesor dhe të refuzimit të të gjitha vizave të rastit në kohën e intervistës për vizë. Ju duhet të përfshini në regjistrimin tuaj bashkëshortin/en tuaj edhe në qoftë se keni ndërmend të divorco-

të njëjta si fotografia e aplikantit. "Sigurohuni që të përfshini të gjithë fëmijët biologjikë, të gjithë fëmijët ligjshëm të bërësuar nga ju dhe të gjithë fëmijët/thjeshtërit nga martesat e mëparshme që janë të pamartuar dhe nën moshën 21 vjeç në datën e aplikimit tuaj elektronik, madje edhe në qoftë se ju nuk jeni më të martuar ligjshëm me prindin e fëmijës dhe madje edhe në qoftë se fëmija aktualisht nuk banon me ju dhe/ose nuk do të emigrojë me ju. Fëmijët e martuar dhe fëmijët 21 vjeç e lart në datën kur ju kryet regjistrimin tuaj nuk janë të pranueshëm për programin e DV-së", - theksohet në njoftim. Mospërfshirja në regjistrimin për lotarinë i të gjithë fëmijëve të cilët kanë të drejtë do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit kryesor dhe të refuzimit të të gjitha vizave të rastit në kohën e intervistës për vizë.

APLIKIMET

Të gjithë aplikantët e DV-2020 duhet të shkojnë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi për DV-2020 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV.

NUMRI I FËMIJËVE

Kandidatët duhet të renditin emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes dhe shtetin e lindjes për të gjithë fëmijët e pamartuar nën moshën 21 vjeç në ditën e regjistrimit elektronik, pavarësisht nëse ata jetojnë apo jo me aplikuesin, apo s'kanë ndërmend ta shoqërojnë në Shtetet e Bashkuara. Në udhëzim theksohet se duhet të ngarkohet fotografi individuale e secilit prej fëmijëve, duke përdorur specifikimet teknike

ARSIMIMI

Në sektorin e nivelit arsimor kandidatët duhet të japin të gjithë informacionin lidhur me nivelin më të lartë të arsimimit që kanë arritur deri më sot. Alternativat që jepen janë: vetëm shkollë fillore, disa vite shkollë të mesme, pa diplomë; diploma e shkollës së mesme; shkollë profesionale; disa kurse universiteti; diplomë universitare; disa nivele të kurseve pasuniversitare; master; disa kurse të doktoraturës; si dhe doktoraturë.

Përzgjedhja e aplikantëve bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet do të bëhet rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Të gjithë aplikantët e DV-2020 duhet të shkojnë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi për DV-2020 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të E-DV www.dvlottery.state.gov duke filluar nga 7 maji 2019 deri të paktën më 30 shtator 2020.

PUBLIKIMI I LIDHJEVE TË DASHURISË NUK ËSHTË TENDENCË

Ja kush janë VIP-et që nuk janë fotografuar kurrë me meshkuj

Përgënjeshttrimet e historive më të përfolura

Egla Xhemali

Për një pjesë të personazheve të famshëm publikimi i lidhjeve nuk është tendencë. Ka disa emra të show bizit shqiptarë që nuk janë fotografuar kurrë me ndonjë mashkull. Ato kanë ruajtur me fanatizëm privatësinë duke mos u bërë pre'e mediave rozë.

ROSELA GJYLBEGU

Këngëtarja e dashur për publikun Rosela Gjylbegu ka preferuar që ta mbaj larg gjithçkaje tjetër jetën private. Ajo ka ditur të mbrohet mjaft mirë duke mos rënë kurrë në gjurmët e paparacëve dhe duke u lënë të tjerëve hapësira për të mësuar vetëm për pasionin dhe profesionin e saj, muzikën. Rosela është treguar e prerë kur bëhet fjala për anën tjetër, për pjesën e raporteve. Ajo nuk ka qenë kurrë në vëmendjen e mediave.

OLTA GIXHARI

Për natyrën e saj ekspresive ajo është një nga femrat më të përfolura të momentit. E kemi fjalën për Olta Gixharin, e cila shpesh është bërë pjesë e mediave rozë për lidhjet e saj intime. Dikur ajo përflitej për një lidhje dashurie me aktorin Nik Xhelilaj pasi shiheshin shpesh në shoqërinë e njëri-tjetrit. Mirëpo asnjëri prej të dyve nuk kishte pranuar kurrë se ishin në një marrëdhënie intime. Olta tregoi të vërtetën e historisë me kolegun e saj duke pohuar se ata të dy kanë qenë shokë shkolle. Duhet theksuar fakti që aktorese nuk i ka qarkulluar asnjë foto me ndonjë mashkull. Ajo ia ka dalë të mbaj jetën private larg publikut.

GRETA KOÇI

Këngëtarja ka qenë gjithmonë hermetike sa i përket jetës së saj private. Për



një periudhë të gjatë kohe për Greta Koçin qarkulloi një lajm për një lidhje të mundshme. Ajo sqaroi se nuk ka asgjë në jetën e saj dhe se njerëzit u keqkuptuan nga titulli i këngës së publikuar. "Në fakt, në

jetën time private nuk ka asnjë mashkull. Jam shumë e dashuruar me familjen time dhe me muzikën. Kur të vijë momenti që të kem një lidhje, do t'ju them", ka përfunduar këngëtarja. Koçi ka arritur t'i bëjë edhe

më kureshtarë fansat dhe jo vetëm duke e mbajtur të fshehtë anën përtej muzikës, lidhjet e saj.

ALBANA OSMANI

Moderatorja e disa emisioneve në "Top Channel", Albana Osmani nuk ka krijuar asnjëherë hapësira për të marrë vesh diçka sa i përket jetës së saj private. Para disa kohësh ajo ishte në qendër të vëmendjes së mediave rozë për një lidhje me ish-banorin e "Big Brother-it" Anaidi, pas një komenti që ky i fundit i la në një foto. Kjo bërë që të hamendësohej se mes tyre ka diçka. Albana pati një reagim për lajmin që sipas saj ishte thjesht një thashetheme dhe se me Anaidin nuk kishte asgjë më shumë veç shoqërisë. Moderatorën nuk kanë arritur ta fotografonjë kurrë me ndonjë mashkull. As ajo vetë nuk ka folur për ndonjë lidhje të mundshme dashurie.


LEONORA JAKUPI

Ka shumë vite në skenë megjithatë nuk mbahet mend për ndonjë skandal. Jeta e saj private mbetet vetëm e saj dhe e paprekur nga mediat. Në fakt, Leonora Jakupi, ka dashur të mos



e përziej profesionin me gjëra që nuk kanë të bëjnë me skenën. Nuk ka asnjë fotografi shkrepur nga paparacët. Ajo është treguar mjaft e kujdesshme duke mos krijuar shtigje për ta gjurmuar. Pak kohë më parë

Leonora ka pranuar se është në një lidhje mirëpo ende nuk qarkullon asnjë foto e çiftit. Jakupi ka pohuar gjithashtu se martesën e sheh si vendim të largët dhe se ndihet mirë kështu siç është.



Rasheli bën postimin provokues, zbuloni pse qesh bukuroshja

Ajo është "tërmet" i rrjeteve sociale. 19-vjeçarja më e famshme në Shqipëri ka provokuar sërish fansat e saj. Të pasmet bombastike janë kthyer në fokusin e kikbokseres dhe ajo kujdeset që t'i ekspozojë sa më shpesh. "Like nëse të pëlqen golfi" shkruan Rasheli shoqëruar me emoji të qeshur. Tashmë dhe ajo është e vetëdijshme për arsyen pse i merr "like"-et.



Albërije Hadërgjonajn nuk do e njihni, ja çfarë ka bërë ajo

Albërije Hadërgjonaj ka befuar me postimet e saj më të fundit. Ajo shfaqet krejtësisht ndryshe dhe pakkush mund ta njohë se është ajo. Këngëtarja ka lyer flokët në brune shumë të errët dhe tualeti e ka bërë të mos duket e njëjta. Shpesh Albëria është vënë në qendër të sulmeve se ka kryer shumë kirurgji plastike. Këngëtarja nuk tregon aspak moshën e vërtetë, ajo duket mjaft rinore.



E kuqe që të tundon, Kejvina "djeg" rrjetin me pozat mbi motor

Velina e "Xing me Ermalin" thuhet se çdo ditë ndan me fansat e saj foto mjaft provokuese. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe në imazhet e fundit që bukuroshja ka postuar në rrjetet sociale. Këtë herë ajo është shfaqur tejet tunduese me veshjen e saj të kuqe, një ngjyrë shumë e preferuar e modeles. Pozat e radhës Kejvina ka zgjedhur t'i realizojë mbi motor dhe makinë. Më provokuese se kaq nuk mund ta shihnit bukuroshen.



Më të lumtur se kurrë, Nora dhe Roberti japin lajmin e shumëpritur

Më në fund ia dolën dhe tashmë Nora dhe Robert Berisha kanë një superlajm për të gjithë fansat. Tashmë dyshja e famshme e "showbiz"-it kanë marrë pasaportat e Republikës së Shqipërisë. Lajmin e gëzueshëm e ka dhënë Roberti me anë të një fotoje të postuar në "Instastory". Edhe fansat e çiftit janë lumturuar! Tashmë ne kemi dy shtetas të rinj VIP që i përkasin republikës sonë.



BOSI I 'ALIBABA' HISTORIA

Miliarderi kinez: Do ta dini shumë shpejt. Kam përgatitur një Fondacion

Themeluesi i "Alibaba", Jack Ma, bën gati lamtumirën

"Jeta është vërtet vetëm një kuti me çokollata"

Njeriu më i pasur i Kinës, Jack Ma, po përgatit bazat për një të ardhme larg 'Alibaba', kompanisë që ai bashkëthemeloi dhe e ktheu në një forcë të jashtëzakonshme në tregtinë online. Në një intervistë për Bloomberg, Ma u shpreh se po i dedikon më shumë kohë dhe pasuri filantropisë, me krijimin e një fondacioni me emrin e tij, të fokusuar në edukimin. Në këtë mënyrë, Ma do të ndjekë hapat e miliarderit amerikan Bill Gates. Teksa themeluesi i 'Alibaba' e sheh veten si një drejtues aksidental, i cili hyri në botën e biznesit me kompaninë e tij 20 vite më parë, ai është bërë një prej liderëve të korporatave më të njohura të Kinës. Edhe pasi dha dorëheqjen si CEO në vitin 2013, ish mësuasi i anglishtes mbetet fytyra publike e kompanisë me një vlerë tregu prej mbi 400 miliardë dollarësh, e cila ka interes nga tregtia online, tek prodhimi i filmave të Hollywood, procesimi cloud dhe pagesat online. "Ka shumë gjëra që mund të mësoj nga Bill Gates. Unë nuk mund të jem kurrë aq i pasur, por një gjë që mund ta bëj më mirë është të tërhiqem më herët. Mendoj se një ditë, së shpejti, do t'i rikthehem mësimdhënies. Kjo është diçka që mund ta bëj shumë më mirë se sa të jem CEO i 'Alibaba'", deklaroi Ma në intervistë. I pyetur nëse diçka e tillë mund të ndodhë këtë vit, miliarderi kinez u përgjigj duke buzëqeshur: "Do ta dini shumë shpejt. Kam përgatitur një Fondacion Jack Ma. Të gjitha këto gjëra i kam përgatitur prej 10 vjetësh". Ma u lind në shtator 1964 në familjen e disa muzikantëve



Jack Ma, themeluesi i "Alibaba"

tradicionale në Hangzhou, një qytet të lashtë, i cili është shndërruar në një qendër botërore e teknologjisë së lartë dhe bastion i sipërmarrjes, për shkak pjesërisht, sepse baza e Alibaba ndodhet atje. Ai e nisi kompaninë Alibaba.com në vitin 1999, si një platformë business-to-business, mbështetur nga 60 mijë dollarë nga 18 bashkëthemelues. Me disa marrëveshje të zgjuara dhe një investim nga SoftBank, platforma u shndërrua në një gjigand të tregtisë online.

Vitin e kaluar shpërndarjet e pakove arritën në 55 milionë në ditë. Ma, gjithashtu, kontrollon Ant Financial, platformën financiare online, e cila kontrollon sistemin e pagesave celulare më të madh në Kinë. Biznesi ka mbi 870 milionë përdorues, përmes pagesave të sistemit Alipay dhe partnerëve të tij. Alibaba ka aktualisht një prej ekipeve menaxhuese më të fuqishme në Kinë. Edhe nëse Ma tërhiqet, ai do të ketë sërish një rol në caktimin e

strategjive kryesore. Kjo pasi Alibaba mbetet i kontrolluar nga një strukturë partnere, e cila i lejon disa ekzekutivë dhe partnerë të vendosin mbi nominimet e bordit. "Kam besim të plotë tek ekipi im dhe tek struktura partnere, të cilën shumë investitorë nuk e pëlqejnë. Është sistemi ku unë mendoj se kam kontribuar së bashku me ekipin tim dhe kjo do të bëjë të mundur që kompania të zgjasë për një kohë të gjatë", u shpreh Jack Ma. Fokusi i

JACK MA

"Ka shumë gjëra që mund të mësoj nga Bill Gates. Unë nuk mund të jem kurrë aq i pasur, por një gjë që mund ta bëj më mirë është të tërhiqem më herët. Mendoj se një ditë, së shpejti, do t'i rikthehem mësimdhënies. Kjo është diçka që mund ta bëj shumë më mirë se sa të jem CEO i 'Alibaba'", deklaroi Ma në intervistë.

bamirësisë të tij tek edukimi është i qartë, për shkak se Ma ka folur shpesh për rëndësinë e arsimit për të dhe mangësitë e tij si student, kur ngeli dy herë në provimin kombëtar të Kinës për në universitet. Ma e sheh filantropinë edhe si një mënyrë për të ngritur një urë që lidh dallimet mes dy ekonomive më të mëdha të botës, Kinën dhe SHBA. Kjo i mundësoi atij një pozicion pune për qeverinë kineze me praninë e tyre të re në internet. Por, pas vetëm disa vitesh të tjera, ai u largua në vitin 1999 për të realizuar ambicjet e tij më të mëdha. Ai ftoi shumë miq në banesën e tij dhe ngriti idenë e tij të themelimit të një faqe online tregtare kineze. Ai mbledhi mbi \$60,000 atë natë dhe kështu lindi sajti 'Alibaba'. Në një fjalim të dhënë për ekipin e tij në vitin e parë 'Alibaba'-së, ai u shpreh: "Amerikanët janë të fortë në hardware dhe sisteme. Por për informacionin dhe softwaret, truri i kinëzëve është po aq i mirë sa edhe i atyre. Kjo është arsyeja që ne guxojmë të konkurrojmë me amerikanët. Në qoftë se ne jemi një ekip i

mirë dhe e dimë se çfarë duam të bëjmë, njëri prej nesh mund të mundë shumë prej tyre." Historia e Alibaba-së ka qenë një zgjerim i vazhdueshëm me gatishmërinë për t'u zhytur në tregje të reja. Ashtu si ambicia e Jack Ma për veten e tij, edhe për Alibabën nuk ka asgjë të pamundur. 'Alibaba' filloi thjesht, si një vend ku eksportuesit postonin ofertat e tyre të produkteve për blerësit e huaj. Menjëherë pas kësaj, filloi 1688.com për transaksionet e brendshme me shumicë. Nuk është befasi që Alibaba ka një vlerë mbi 180 miliardë \$. Jack Ma ka ngritur një pasuri miliardë dollarësh, por ky nuk ishte qëllimi i tij drejt suksesit. Sigurisht, për aq shumë suksese që 'Alibaba' ka pasur, ka kaluar edhe dështime. "Unë e quaj 'Alibaba'-n "1.001 gabimet". U zgjeruam shumë shpejt dhe pastaj u detyruam të bënim pushime nga puna... Deri në vitin 2002 kemi pasur të holla të mjaftueshme vetëm për të mbijetuar për 18 muaj. Ne nuk e dinim si mund të fitonim para. Për Ma, jeta është vërtet vetëm një kuti me çokollata.

RIKTHEHET 11 SHTATORI? AVIONI USHTARAK FUTET MES GRADAÇELAVE NË AUSTRALI

Ditën e djeshme, punonjësit e zyrave mbetën të tmerruar kur një avion i Forcave Ajrore Australiane fluturonte vetëm pak metra në distancë nga ndërtesat e larta gjatë një festivali. Avioni Boeing C-17 ishte pjesë e repartit ikonik të Brinbane "Riverfire". Pamjet e avionit gjigant duke fluturuar në mes të qytetit e gradaçelave, i habitën të gjithë. Madje një spektator i krahasoi këto pamje me ato të 11 shtatorit 2001 kur avioni terrorist përplasi Kullat Binjake në SHBA. Në rrjetet sociale ky numër u cilësua si "i panevojshëm dhe i rrezikshëm".



FOTOLAJM

SHKURT

E tmerrshme në Greqi, gjenden tri femra të masakruara

Një skenë e ngjashme për filma horror: Tri femra, origjina e të cilave ende nuk dihet janë gjetur të vdekur në Greqi, pak metra larg lumit Evros në kufi me Turqinë. Siç raportojnë mediat helene ato janë të moshës 15-30 vjeç, duke hedhur edhe dyshime se mund të jenë nëna dhe dy vajzat e saj. Ato kishin plagë në trup, dy prej tyre ishin të lidhura me njëra tjetër, ndërsa tjetra ndodhej disa metra larg. Pranë tyre është gjetur edhe një thikë, e cila zakonisht përdoret nga gjuetarët. Arma e ftohtë është dërguar në laboratorë mjeko-ligjorë, për të zbuluar gjurmët e gishtave. Ndërsa fakti që njëra prej tyre nuk ishte e lidhur përbën një tjetër mister, shkruan Prothotema. Një nga pistat kryesore të hetimit është ajo e përdhunimit dhe më pas vrasjes. Trupat e tri femrave janë gjetur 50 metra larg kufirit, një vend që përdoret për kalimin e emigrantëve të paligjshme. Kjo i bën oficerët e policisë të dyshojnë se mund të bëhet fjalë për gra emigrante që donin të kalonin ilegalisht nga Turqia në Greqi, ndoshta për të kërkuar azil.



Ministri i Jashtëm: Ky është qëndrimi i presidencës së Bosnjës

"Kosova e pavarur", Daçiç i kthehet anëtarit të presidencës së Bosnjës

Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiç i është kundërpërgjigjur anëtarit të zgjedhur të presidencës së Bosnjës, Zheļjko Komshić, pas deklaratës së këtij të fundit se Kosova është shtet i pavarur. Teksa e ka cilësuar provokim për Serbinë, Daçiç tha se Komshić ende nuk e ka marrë detyrën e tij. Kryediplomati u shpreh se e konsideron Republikën Srpska shtet po aq të pavarur

IVICA DAÇIÇ:

"Komshić ende nuk e ka marrë detyrën e tij. Republikën Srpska e konsiderojmë si shtet po aq të pavarur sa Kosova. Nëse ju mund ta konsideroni personalisht Kosovën të pavarur, por ky nuk është qëndrimi i presidencës së Bosnjës", - ka thënë Daçiç.

sa Kosova. Daçiç i vuri në dukje Komshić faktin se ai mund ta konsiderojë personalisht Kosovën të pavarur, por ky nuk është qëndrimi i presidencës së

Bosnjës. Ndërkaq, para disa ditësh kryeministria e Serbisë, Ana Brnabic i është shmangur pyetjes lidhur me faktin nëse shteti i saj do ta njohë apo jo pa-

varësinë e Kosovës, nëse merr Veriun. "Çfarëdo që unë mund të them mund të keqpërdoret në të mirë ose në të keqe. Sipas pozicionit tim, unë nuk mund ta imagjinoj që Serbia mund ta njohë Kosovën në atë formë dhe në atë mënyrë. Unë mendoj se jam liberale, por është një pyetje tmerresisht emocionale dhe është shumë e vështirë të flasësh lidhur me këtë", tha Brnabic. Po ashtu ajo është ndalur edhe tek dia-



Ministri i Jashtëm i Serbisë Ivica Daçiç

logu në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit është shumë i vështirë dhe sfidues. Ësh-

të papërgjegjësi të thuhet se gjendja e status-quoos është e mirë, disa politikanë opozitarë e thonë këtë", -tha kryeministria.

U dënua me 2 vjet burg, ish-kryeministri për 20 ditë prapa grilave

Kryeprokurorja: Gruevski së shpejti do jetë në burg

Rasti "Tanku", ja të akuzuarit e tjerë të përfshirë

Kryeprokurorja Speciale ne Maqedoni, Katica Janeva ka theksuar dje se shpreson se ish-kryeministri Nikolla Gruevski shumë shpejt do të jetë në burg. Ajo në emisionin "Vetëm e vërteta" në Kanal5 ka theksuar se së shpejti do ta shoh Gruevskin prapa grilave, pas dënimit të tij me 2 vjet burg për rastin "Tanku", lidhur me furnizimin me Bensin e blinduar. "Shpresoj se Gruevskin se shpejti do ta shohin prapa grilave. Nga përvoja që kam mund të them se kjo do të ndodhë për 20 ditë. Deri të premtën pres aktgjykimin nga Gjykata e Apelit në Shkup, që do të dërgohet në formë të shkruar edhe tek Prokuroria jonë Speciale, dhe pas kësaj edhe Gruevski do të marrë vendimin dhe që mund të shkojë në burg", theksoi Janeva, informon INA. Gjykata e Apelit vërtetoi dënimin prej 2 viteve burg për ish-kryeministrin Gruevski, i cili tashmë s'ka ku të shkojë pas dënimit të plotfuqishëm. Ndërkohë që në fillim të muajit Gjykata e Apelit në Shkup refuzoi ankesën e ish-kryeministrin, Nikolla Gruevski, për çështjen "Tanku" dhe në tërësi e vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë për dënim me burgim prej dy vitesh. Gjykata pjesërisht e pranoi ankesën e ish-ndihmësministrit të akuzuar të Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski dhe e ndryshoi pjesën e dënimit për dënimin dhe e dënoi me dënim me burg në 4.6 vite, ndërsa në pjesën tjetër vendimin e shkallës së parë e vërtetoi. Gjykata Penale në Shkup më 23 maj të këtij viti për furnizimin e "Mercedesit" luksoz në vlerë prej 600 mijë euro e dënoi të akuzuarin e parë, Gjoko Popovski me 6.6 vite burg, ndërsa të akuzuarin e dytë Nikolla Gruevski si nxitës për kryerjen e veprës në dy vjet burg, përcjell ALSAT. Gjykata Apelit ka konfirmuar masën e dënimit për ish-kryeministrin, Nikolla



Ish kryeministri Maqedonas, Nikolla Gruevski

KRYEPROKURORJA KATICA JANEVA

"Shpresoj se Gruevskin së shpejti do ta shohin prapa grilave. Nga përvoja që kam mund të them se kjo do të ndodhë për 20 ditë. Deri të premtën pres aktgjykimin nga Gjykata e Apelit në Shkup, që do të dërgohet në formë të shkruar edhe tek Prokuroria jonë Speciale, dhe pas kësaj edhe Gruevski do të marrë vendimin dhe që mund të shkojë në burg", -theksoi Janeva.

2

VJET BURG PËR 600 MIJË EURO

Gjykata Penale në Shkup më 23 maj të këtij viti për furnizimin e "Mercedesit" luksoz në vlerë prej 600 mijë euro e dënoi të akuzuarin e parë, Gjoko Popovski me 6.6 vite burg, ndërsa të akuzuarin e dytë Nikolla Gruevski si nxitës për kryerjen e veprës në dy vjet burg.

Gruevski, në rastin "Tanku". Nga ana tjetër, Gjykata e shkallës së dytë ka ulur për 2 vjet dënimin për Gjoko Pop-

ovskin i dënua po për të njëjtin veprë. Në këtë rast u përfshi edhe ish-ministria e Punëve të Brendshme e

Maqedonisë, Gordana Jankulovska. Ajo u dënua me 6 vjet burgim për shpërdorim të detyrës në aferën e njo-

hur me emrin "Tanku". Gjykata Penale e Shkupit e shpalli fajtores Jankulovskën për shkelje të procedurës së blerjes së një makine të blinduar për ish-kryeministrin e Maqedonisë, Nikolla Gruevski, në vlerë prej 600 mijë eurosh. Gjykatësja Dobrila Kacarska tha se makina është blerë nga MPB-ja, por nga dëshmitë e siguruar ka rezultuar se, në fakt, ajo "është blerë për ish-kryeministrin Gruevski". Gjykatësja tha se aspektet teknike të tenderit kanë favorizuar një kompani, ndërsa janë kërkuar edhe kushte të tjera të posaçme, me çka është përjashtuar mundësia e subjekteve tjera për të marrë pjesën në tender. Për të njëjtin rast, me 2 vjet burgim është dënua edhe Gruevski, ndërsa me 4.5 vjet Gjoko Popovski, ish-zyrtar i lartë në Ministrinë e Brendshme. Skandali është zbuluar nga afëra e përgjimeve që ishte publikuar nga opozita në shkurt të vitit 2015, ndërsa rasti është proceduar nga Prokuroria Speciale e Maqedonisë, e cila është themeluar për hetimin e shpërdorimeve të qeverisë së kaluar. Akuzat janë hedhur poshtë nga zyrtarët e dënua duke i vlerësuar ato si "të motivuara politikisht". Jankulovska vazhdimisht ka qenë në shënjestër të kritikave, në veçanti të opinionit shqiptar, për shkak të ofendimeve në adresë të shqiptarëve, të cilët në disa raste i ka quajtur "indianë".

SHKURT

Emergjencë nga moti i keq në Sardenjë

Situatë katastrofike nga reshjet e dendura dhe përmbytjet edhe në Sardenjë. Një grua humbi jetën, teksa ujërat e furishëm në rrugë tërhuqën automjetin e saj drejt lumenjve të dalë nga shtrati. Një tjetër person rezultoi i zhdukur. Reshjet e dendura shndërruan për disa orë disa rrugë në periferi të Kaljarit në lumenj. Dëme të konsiderueshme janë shkakuar edhe në infrastrukturën rrugore, ku pati edhe disa ura të dëmtuara. Autoritetet italiane mbyllën shkollat dhe institucionet tjera publike, deri në përmirësimin e situatës.

Uragani "Michael" godet jugperëndimin e SHBA

Uragani Michael, më i fuqishmi në 25 vite, goditi brigjet jugore amerikane me një fuqi shkatërrimtare, duke shkakuar 2 viktimat e para. Erërat e forta me një shpejtësi deri 250 km/orë dëmtuan rëndë ndërtesat përgjatë brigjeve të Floridas. Të tjera u rrafshuan krejtësisht. Në disa zona bregdetare, deti hyri në brendësi të zonave të banuara duke mbuluar katet e para të ndërtesave. Dëme më të mëdha pati në Florida e Xhorxhia, ku mijëra banorë janë evakuuar nga zonat e rrezikuara. Mbi 500 mijë të tjerë janë pa energji elektrike. Presidenti Trump shpalli gjendjen e emergjencës në Florida, teksa erërat e forta po drejtohen drejt Karolinës së Jugut dhe Veriut.

SHKRIMTARET NE DIKTATURE

Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

Ekskluzive/ Publikohet letra për Ramiz Alinë e vitit 1970, detajet e denoncimit

Mitrojorgji: Ja përse na sulmon Paçrami mua dhe Lazar Siliqin

"Ai e konsideron Spahivoglin, Radin e Kiço Blushin si e ardhmja e dramaturgjisë sonë"

Nga Dashnor Kaloçi

Gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist të paraviteve '90-të, me ndonjë përjashtim të rrallë, asnjë nga "personalitetet" e udhëheqjes së lartë, si psh., anëtarët e Byrosë Politike apo Komitetit Qendror të PPSH-së nuk merrej me shkrime të karakterit letrar apo publicistik nëpër gazeta apo revista, ndërsa për libra as që bëhej fjalë. Përjashtim bënin Myslym Peza dhe Shefqet Peçi, dy nga më të moshuarit e udhëheqjes së lartë, të cilët edhe për shkak të moshës, nga fundi i viteve '70-të dhe fillimi i viteve '80-të, Partia i kishte "sistemuar" si nënkryetarë të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ku ata kishin edhe kohën e mundshme "për të shkruar". Kështu, ndërsa Myslym Peza kishte "shkruar" një libër me kujtime "Kur dhashë besën", Shefqet Peçi kishte botuar ndonjë libër me poezi apo me "tregime nga Lufta Nacional-Çlirimtare", gjë të cilën ai e vazhdoi deri në shembjen e regjimit komunist. Ndërsa me librin politik, ai filloi në vitin 1966, kur me vendim të sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH-së u vendos që të botohej "Vepra e zgjedhur e shokut Enver Hoxha", ku një pjesë e fjalimeve të tij të mbajtura ndër vite, apo raportet nëpër kongrese, plenumet etj., u morën dhe pas përpunimit nga ana e Institutit të Studimeve Marksiste Leniniste (që drejtohej nga Nexhije Hoxha) u botuan në seri (dhjetëra vëllime) deri në shembjen e regjimit komunist. Po kështu, përveç Enverit, në gjallje të tij botoi disa libra edhe Mehmet Shehu, (kryesisht me tregime nga Lufta Nacional-Çlirimtare), kurse pas vdekjes iu botuan disa libra edhe për Hysni Kapon e Gogo Nushin. Dhe të gjithë këto botime, siç theksuam pak më lart, ishin nën kujdesin dhe kontrollin e rreptë të Institutit të Studimeve Marksiste Leniniste, ku çdo gjë shikohej "me luptë" nga Nexhmija. I vetmi nga udhëheqja e lartë që i kishte "shpëtuar" këtij kontrolli ishte Fadil Paçrami, i cili që në vitet '60-të shkruante rregullisht në shtypin letrar, ishte autor i disa librave, kryesisht me drama dhe deri në vitin 1973, ai konsiderohej edhe si një nga dramaturgët më prodhimtarë për vënie në skenë të dramave të tij. Pikërisht për shkak të shkrimeve, apo siç thuhet asoko-



he "njeri i letrave", Fadil Paçrami ishte bërë shumë i njohur dhe kishte një autoritet të madh nga e gjithë udhëheqja e lartë. Si rezultat, edhe pse ai ishte vetëm anëtar i Komitetit Qendror të PPSH-së dhe sekretar i Komitetit të Partisë të Tiranës për Propagandën, deri në vitin 1973, emri i tij ishte shumë më i njohur dhe ai gëzonte një popullaritet shumë më të madh edhe se pjesa më e madhe e anëtarëve të Byrosë Politike. Por, kjo anë pozitive e Fadil Paçramit si dramaturg, shkrimtar dhe publicist kishte edhe anën tjetër të medaljes, xhe-

lozinë. Dhe kjo, si nga kolegët e tij shkrimtarë dhe artistë, ashtu dhe nga "shokët e udhëheqjes", madje thuhet se edhe nga vetë Enver Hoxha, gjë e cila u vërtetua plotësisht në fillimin e vitit 1973, kur Enveri kritikoi dhe goditi Festivalin e 11 Kombëtar të Këngës në Radio-Televizion, duke akuzuar fillimisht Todi Lubonjën dhe më pas edhe vetë Fadilin, ku një nga akuzat që i bëri atij, ishte: "Fadili nuk merrej me punët që i kishte ngarkuar Partia, por vetëm me dramet e tij". E gjitha kjo përkthehej ndryshe si një xhelozie e diktatorit komunist



etj., të cilët Fadili i vlerësonte si e ardhmja e dramaturgjisë shqiptare. Sidoqoftë, këto gjëra mbeten për t'u parë dhe "rakorduar", edhe me dokumente të tjera që publikohen në faqet e këtij libri dhe jo vetëm, pasi shumë nga këto "kritika" që i bëheshin Fadil Paçramit në vitin 1970, në 1973-in u përkthyen në akuza ndaj tij, ashtu dhe atyre kolegëve të tij shkrimtarë, si Spahivogli, Xhuvani, Radi e deri te Kiço Blushi, të cilët siç duhet tashmë, patën jo pak problem dhe peripeci. Ndërkaq, ashtu si dhe pjesa më e madhe e dokumenteve të këtij libri, edhe ky publikohet i plotë dhe pa asnjë shkurtim.

DISA VËREJTJE RRETH DISKUTIMIT TE SHOKUT FADIL PAÇRAMI NE PLENUMIN E LIDHJES SE SHKRIMTAREVE DHE ARTISTEVE MBI DRAMATURGJINE

1. Diskutimi përshkohet nga disa nota shqetësuese, frike dhe alarmi për gjendjen e dramaturgjisë e teatrit dhe të ardhmen e tyre. Ai thotë:

"Të pushojnë kërkesat për drama pa konflikt, drama limonadë, drama pa telashe".

"Të marrin fund shqetësimet e frika se kur në dramë konflikti është i ashpër dikush do ta pësojë".




"Të marrë fund kërkesa absurde dhe jo nga pozita klasore që në fund të gjithë rregullohen, e cila është një kërkesë për të dobësuar dhe zbutur konfliktet.

"Të marrin fund thirrjet për kompromis në art.

"Siç venë punët, është bërë çështje trimërie të ngjitesh në skenë dhe më shumë mund, kohë e sidomos nerva, harxhojmë e prishim kur na vihet në skenë një pjesë se sa kur e shkruajmë.

Po kujt i drejtohen këto thirrje për t'i dhënë fund kësaj dhe asaj çështjeje? Kush duhet të pushojë kërkesat për këtë dhe atë çështje? Kush ia krijon këto shqetësime?"

ndaj Paçramit, por para se të arrinte viti 1973, xhelozia ndaj Paçramit kishte filluar pak më herët... Gjë e cila veç të tjerash, duket edhe nga ky dokument arkivor i vitit 1970, ku Pipi Mitrojorgji, asokohe instruktor në Komitetin Qendror të PPSH-së për letërsinë dhe artet u ka nisur eprore të tij të udhëheqjes së lartë, një letër me "disa vërejtje rreth diskutimit të shokut Fadil Paçrami në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve mbi dramaturgjinë". Ky dokument, më shumë se sa ashtu siç është titulluar, "disa vërejtje", është një denoncim i pastër dhe një hakmarrje ndaj Paçramit, pasi ai (Fadil) pak kohë më parë kishte bërë një shkrim kritik në gazetën "Drita" kundër L Lazar Siliqit dhe Pipi Mitrojorgjit. Gjë e cila mund të shihet edhe si një "luftë konkurrentësh" apo klanesh ndërmjet njerëzve drejtues të artit e kulturës, ku Siliqi dhe Mitrojorgji duket se nuk e kanë duruar dot fudullëkun që thuhet se e karakterizonte Paçramin në raportet me kolegët e tij shkrimtarë. Dhe në këtë kontekst, përveç Paçramit, në shkrimin e tyre ata kanë hedhur shigjeta kritike edhe ndaj disa kolegëve të tyre shkrimtarë, si Kujtim Spahivogli, Dhimitër Xhuvani, Kiço Blushi, Vath Koreshti



mohojmë veçoritë e artit dhe kur vëmë me të drejtë theksin tek idetë, nënkuptojmë veshjen e tyre me figurën artistike. Idetë e kohës sonë duke qenë të mëdha, kanë një forcë të madhe emocionale e frymëzuese.

Krijimtaria e shokut Fadil ka mjaft anë pozitive. Ajo dallohet për kujdesin e veçantë, që i kushton evidentimit të mendimit filozofik të ngjarjeve. Në dramën e tij vihet re qartë ballafaqimi i konflikteve, guximi në trajtimin e tyre, tendenca e shëndoshë për të shndërruar skenën në një arenë lufte ideologjike me përpjesëtime të gjera. Por krahas këtyre anëve të tjera pozitive, dramën e shokut Fadil vuajnë nga një e metë serioze, nga dobësia e figurave artistike, nga dobësia e veshjes së mendimeve me element të domosdoshme artistike që e pasurojnë dhe e fuqizojnë, dhe kristalizojnë në mirë idenë. Këtë të vërtetë nuk do ta pranohet dhe kujton se këtu qëndron një nga dobësit kryesore të tij si dramaturg. Krijimtaria e shokut Fadil ka nevojë për më tepër frymëzime artistike, fantazi krijuese dhe talent letrar.

3) Diskutimi i shokut Fadil ka një notë të fortë pakënaqësie ndaj kritikës letraro-artistike. Veç artikullit kritik mbi dramën "20 ditë", ai është i pakënaqur edhe me kritikën ndaj dramës "Njollat e murrme". Sipas tij, kritika nuk ka ndjekur thelbin e çështjes. Unë mendoj se kritika e ka tënë mirë fjalën e saj për dramën "Njollat e murrme". Nga gabimet e kësaj drame dhe analizat që iu bënë, mësuam shumë të gjithë ata që kanë dashur të mësojnë. Artikulli i botuar në "Zëri i Popullit" u prit shumë mirë, veç të tjerave dhe nga fryma parimore dashamirëse që e përshkonte, nga ndjenja e masës në vlerësimin e gabimeve ideore. Por, kjo pakënaqësi e shokut Fadil ndaj kritikës letrare rrjedh nga disa qëndrime që nuk përputhen me mendimet e tij dhe kjo që çudit dhe e revoltin. Shoku Fadil është për ballafaqimin e mendimeve, por jo me mendime që u kundërvihen vlerësimeve të tij. Prej diskutimit të tij mbi këtë temë lihet përshytyja sikur njolla, koncepte ideore estetike jo plotësisht socialiste e shije jo gjithmonë të shëndosha, ka tek të tjerët, por jo tek ai, sikur mendimet e tij janë absolute. Ky qëndrim e çon në subjektivizëm siç është rasti i vlerësimit prej tij të filmit "Gjurma", për të cilin trillon konfliktin e tri brezave. Që të ekzistonte ky konflikt duhej që të tre personazhet, doktorë të filmit të viheshin në konflikt midis tyre, kurse në film nuk ekziston një gjë e tillë. Moshat të ndryshme ka dhe do të ketë në çdo veprim artistike, por kjo nuk do të thotë se ka automatikisht konflikt brezash.

Kritika jonë letrare e artistike ka të meta e dobësi, ka edhe qëndrime jo të drejta, vlerësime të gabuara, probleme ideore edhe të asaj natyre që shtron edhe shoku Fadil. Por, rritja e nivelit të kritikës do të bëhet duke e orientuar atë drejtë, në bazë të mësimëve të Partisë e të shokut Enver, e jo të pikëpamjeve tona subjektive. Ajo do të rritet duke gjallëruar duke respektuar mendimin e tjetrit kur nuk është i gabuar në vijë, e jo duke e kufizuar ose duke i imponuar asaj mendime të njëanshme.

4) Më duket i shpejtuar entuziazmi që çfaq shoku Fadil për Dhimitër Xhuvanin, Kiço Blushin, Kujtim Spahivoglin, Ferdinand Radin, Vath Koreshin etj., të cilët me gjithë se sapo kanë shkruar një ose dy drama, cilësohen si element shumë inkurajues për të ardhmen dramaturgjike dhe teatrit tonë.

- Po ta gjykojmë çështjen për shokun Fadil si dramaturg, duhet thënë se çdo gjë që i ka dhënë teatrit i është vënë në skenë, bile është autori që ka më shumë pjesë në repertorin aktiv të teatrove tona. Vënia në skenë është bërë duke kontrolluar vetë çdo fazë përgatitore deri në provën e përgjithshme. Pra, s'ka nevojë të përdoren trimëritë për t'u ngjitur në skenë. Në qoftë se ka harxhuar kohë këtë, e ka bërë se ka dashur të ndërhyjë në shumë çështje të regjisë apo teatrit.

- Po ta gjykojmë çështjen për dramaturgjinë në tërësi, përsëri duhet thënë se për vënien në skenë të dramave, kemi pasur raste që ato janë zvarritur, që autorëve të tyre u janë bërë kërkesa të padrejta, ashtu siç kemi pasur edhe raste që janë vënë në skenë drama të dobëta ideologjikisht. Por, në përgjithësi dramat janë vënë në skenë dhe nuk ekziston problem i nënvlefësisë të dramaturgjisë sonë. Në dekadën e fundit, ajo u bë preminuense absolute e skenës sonë. Një shembull konkret: nga 104 dramat e paraqitura në konkurs, 20 janë shfaqur para doerzimit, 25 janë marrë nga teatrot për t'i vënë në skenë. Të tjera u janë kthyer autorëve me vërejtje nga zhuria për ripunim ose si të paarrira. Pra, kemi një situatë normale.

Atëherë, cilat janë arsytet që kanë shkaktuar "prishjen e nervave..." të dramaturgëve? Këto arsye sipas shokut Fadil janë: "Pikëpamjet teknokratike, çfaqjet tipike të burokratizmit të zyrave të drejtorëve, të mbledhjeve të ngushta e të gjera, të komisioneve e grupeve që merren me meremetimin e dramave".

"Inkurajimi që u bëhet teatrove në këtë rrugë nga Ministria e Arsimit-Kulturës".

"Kritikat dhe mendimet diametralisht të kundërta që çfaqen për veprat letrare e artistike në përgjithësi dhe ato dramaturgjike në veçanti".

A janë të justifikuar këto shqetësime, a ka një situatë të tillë

të frike për të cilën është dhënë alarmi dhe a është e vërtetë kërkesa për drama me konflikt, pa telashe, kërkesa me "absurditetin nga pozita jo klasore në art"? A ka vërtet inkurajim nga Ministria për këto çështje të shtrembra? Mendimi im është se probleme të kësaj natyre ka. Në Drejtorinë e Teatrove e deri në ministri mund të ndeshesh me koncepte burokratike, mungesë iniciative e guximi krijues, rutinë e qëndrime konformiste. Në planimin e fundit të Lidhjes mbi dramaturgjinë, në përgjithësi u vunë mirë në dukje si përparimet ashtu dhe problemet e sotme.

Por, ndërsa në plenum u shtruan çështjet duke i parë nga të dyja anët, diskutimi i shokut Fadil është i njëanshëm dhe tendenca e përmbajtjes së diskutimit nuk është pozitive. Ai (shoku Fadil), shikon kryesisht të metat dhe i zmadhon ato. Në shkallën që ngrihen dhe në formën si ngrihen, lihet përshytyja se në praktikë shtrembërohet vija e partisë në art, se preket liria e krijimit të dramaturgëve nga kërkesat e pa drejta të teknokratëve, se krijimi i artit revolucionar pengohet nga thirrjet për "kompromise në art", etj.

Në marrëdhëniet e teatrit me dramaturgjinë, problem shtrohet përsëri i njëanshëm, shikohet konflikti që ekziston midis tyre dhe nuk përmenden fare mundësitë reale që ekzistojnë në fakt për zgjidhjen e kontradiktave. Bile lihet përshytyja e kundërvënies së teatrit ndaj dramaturgjisë, e organeve shtetërore ndaj dramaturgëve. Fërkime të kësaj natyre midis teatrove e dramaturgëve ka pasur e do të ketë vazhdimisht, për vetë natyrën e ndërlikuar të artit, por tek ne këto konflikte zgjidhen mbi bazën e partishmërisë klasore, të qëllimeve të njëjta që kanë si dramaturgët ashtu dhe teatrot.

Shoku Fadil thotë se foli në plenum si dramaturg, por si mund të ndahet ai nga funksionet shumë të rëndësishme të Partisë, nga përgjegjësia e sekretarit të Partisë

për propagandën në kryeqytet, ku çfaqen më të theksuara këto probleme? Në fakt, duke dashur të largohet nga pozita e sekretarit të Komitetit të Partisë për Tiranën, ai bën një gabim tjetër, lë pa përmendur fare punën, përgjegjësinë dhe rolin e organizatave të Partisë për zgjidhjen e këtyre problemeve. Një diskutim i tillë prej "dramaturgu" e privoi plenumin nga një diskutim shumë më i nevojshëm orientues, nga një kuadër partie me përgjegjësi si Fadil që t'i shtronte problemet në një prizëm parimor e direktiv.

2) Në diskutimin e shokut Fadil disa çështje ngrihen në planin teorik. Por, këto çështje teorike përshkohen nga kontradikta të brendshme.

-Se pari, çështja parimisht e drejtë për revolucionarizimin e mëtejshëm të teatrit shtrohet për të argumentuar idenë e të njëanshërisë shikohet shtrembërohet dhe me frikë nga këto dy ide: revolucionarizimi i mëtejshëm i teatrit dhe lufta që duhet bërë për krijimin e teatrit të ri". A ekziston vërtet një mendim i tillë? A shikohen vërtet shtrembërohet dhe me frikë këto dy ide nga punonjësit e teatrit dhe dramaturgët? Në qoftë se kjo është e vërtetë, jemi para një problemi shumë serioz, por unë nuk mendoj se ekziston një problem i këtillë. Tek ne dhe tek të tjerët sigurisht që ka akoma njolla, shije e koncepte konservatore, ashtu siç ka edhe koncepte liberale për këtë ose atë çështje të veçantë të dramaturgjisë apo të skenës. Por, në përgjithësi nuk ekziston frikë dhe as shikohen shtrembërohet idetë për revolucionarizimin e mëtejshëm të teatrit të ri që ka shtruar partia.

Janë të drejta mendimet që thuhet për teatrin e ri për karakterin e tij klasor për ndryshimin esencial nga teatri borgjez reaksionar. Por, problem siç shtrohet, nuk ekziston, veç kësaj më duket se në konkluzionet për krijimin e teatrit të ri fitet vetëm për njërin anë, për mohimin e së vjetrës dhe nuk përmendet baza ekzistuese mbi të cilën ngrihet e reja. Pra, shtrimi i

problem të raportit midis së resë dhe traditës nuk është bërë mbi baza të shëndoshë dialektike.

-Së dyti, tri çështjet e tjera që ngrihen në planin teorik mbi vërtetësinë historike në art, mbi kuptimin e emancipimeve në art dhe mbi thellimin e personazheve, duke qenë se baza mbi të cilat ngrihen është drama "20 ditë" (pra një bazë subjektive) edhe argumentet çalojnë. Pa folur për analogjitë e padrejta, për njëanshëritë e gjykimit të çështjeve etj. Mendimi im është se është i gabuar konkluzioni që nxjerr ai se goja idetë e artikullit të kritikës të Lazhar Siliqit e Pipi Mitrojorgji mbi dramën "19 ditë", (ose "20 ditë"), autori është larguar nga vërtetësia historike, ka rënë në racionalizëm e në formalizëm. Është vërtetuar tashmë se kur nuk respektohet vërtetësia historike, vendin e të vërtetës historike e zë gënjeshtra, e cila futet në psikologjinë e personazheve në veprimet e tyre në karakterin e tyre. Largimi nga e vërteta historike i hap rrugën arbitraritetit dhe spekulimeve formaliste në etikën e novatorizmit. Kjo çështje është shpjeguar shumë mirë nga shoku Enver në fjalën e tij para konferencës së 17 të Partisë të Tiranës në dhjetor 1968.

Gjithashtu, nuk është fjala se çfarë lloj emocioneve krijon drama e shokut Fadil, por për atë që drama e tij duke qenë thjeshtë racionale, nuk krijon emocione. Mendimi i dramës në vetvete nuk mund të krijojë emocione. Emocionet krijohen nga mendimi artistik, dmth., kur mendimi i veprës artistike ngrihet në art, kur vishet me figurën artistike, kur kjo figurë artistike përputhet me mendimin dhe i jep këtë një aftësi penetruese të veçantë, aftësinë për të hyrë jo vetëm në mendjet dhe zemrat e njerëzve, të ndikojë dhe transformojë jo vetëm idetë, por edhe ndjenjat.

Nuk bëhet fjalë as për atë që shtron shoku Fadil se Lazhari dhe Pipi janë kundër dramës së re, por që brendia e dramës së re, idetë e revolucionit tonë, që bart kjo dramë e re, të krijojë tek njerëzit emocione të reja socialiste të thella, të fuqishme, të qëndrueshme. Në trajtimin e kësaj çështjeje, ai thotë: "Veçoria e artit tonë, pra edhe e teatrit, duhet të jetë pikërisht kjo: Vënia në themel të tij idetë e mëdha të kohës". Kjo është plotësisht e drejtë, por ne nuk

IN MEMORIAM

LAMTUMIRË FATOS ARAPI

“Atdheu është dhembje” e “Tirana ka tiranë”, poeti përcillet me vargjet e tij

Fatmira Nikolli


Lamtumirë Fatos Arapi! Shpirti yt prej kohësh që ndarë prej baltës sonë të përditshme. Vështroje poshtë si grindeshim e haheshim si merimanga në vorbën e kohës. Shihje me dhimbje dheun që rrudhej e mpakej prej urrejtjes sonë, prej lakmisë, zilisë, shpirtngushtësisë, babëzisë. Pse o Zot na braktisi perëndi e dashurisë?! Sot poeti zgjodhi përfundimisht qiellin. Prej qiellit të tij do reshin vazhdimisht shirat për ta ruajtur të pastër detin tonë”. Izet Duraku e shprehte dje me këto fjalë dhimbjen për ndarjen nga jeta të poetit Fatos Arapi. Ai u shua në moshën 89-vjeçare pas më shumë se 10 vjetësh në një hesh-tje të plotë dhe pothuaj i tërhequr nga bota përreth. I cilësuar si një prej poetëve më të mëdhenj shqiptarë, i larguar nga ngjarjet e letërsisë për një kohë të gjatë, ai pothuaj u shkëput duke i jetuar vitet e fundit “në vetmi”, pa iu përgjigjur telefonatave dhe trokitjeve mbi derën e tij. As kur pak vite më parë u botua një libër me përmbledhje të poezive, ai nuk doli prej portës. Vite më parë telefonatave për takime e intervista u përgjigjej me refuzim, derisa një ditë, “e hoqi” fishën e telefonit për t’u mënjeluar përgjithnjë.

Në fund të muajit gusht, “Gazeta Shqiptare”, duke marrë shkas nga një postim i studiuesit Izet Duraku, pat botuar një artikull nën titullin “Fatos Arapi, poeti që e lamë në harresë”. “Miq të mi të letrave, ju që nuk e harroni kurrë Fatosin! Do të bashkohem gjithmonë me ju për me ngrit zërin në mbështetje të Fatos Arapit. Duhet respektuar, heshija e tij e shenjtë duke e bërë sa më të zëshme hesh-tjen për me ia shurdhure veshët shurdhnisë”, shënohej duke cituar Durakun. Dy muaj më pas, hesh-tja e tij bëhet e përrjetshme.

HOMAZHET E MIQVE

Nuk u mbajtën për të homazhe, në kuptimin që jemi mësuar t’i nderojmë emrat që ikën. Për të dje, të gjithë vetëm shkruan si e kishin njohur, si do e mbanin mend duke cituar vargjet që e bënë të njohur e vargjet për të cilat e dëshën ata që e lexuan dhe (s’e) kuptuan. Arapi, bashkë me Ismail Kadarenë dhe Dritëro Agollin, bënë pjesë në ata poetë që bënë një

Xhevahir Spahiu në lot, takimi që nuk mundi dot ta bënte



Poeti Fatos Arapi

Preç Zogaj: Më thoshte se Shqipërinë e shpëton dielli

kthesë të rëndësishme në poezinë shqiptare të viteve ‘60. Ai sollti në këtë poezi elemente të modernizmit, madje të hermetizimit. U orientua nga poezia filozofike. Veçanërisht origjinale janë dy përmbledhjet e tij të para poetike “Shtigje poetike” (1962), “Poema dhe vjersha” (1966), “Ritme të hekurta” (1968) është më konformiste derisa më 1971 i botohet në Prishtinë vëllimi “Kaltërsira” dhe vëllimin “Më jepni një emër” ia ndaloi diktatura.

Kur flisnin për trishtimet dhe humnerat ku vrapon marra-mendthi, në mënyrë ciklike fati i vendit tonë, Preç Zogaj kujton se Fatos Arapi shprehej që “Shqipërinë e shpëton dielli”. “M’u kujtua qëparë duke parë diellin në qiellin e Tiranës. Kjo shprehje e jashtëzakonshme nuk e përfshin sot dhimbjen dhe zënë për ndarjen nga jeta të atij që e thoshte, të Fatos Arapit. Një poet i lindur dhe i përkundur në habitatin gjeopoetik midis Adriatikut dhe Jonit, një poeti i Adrionit, Fatos Arapi është nga brumi i poetëve të mëdhenj li-


rikë, që e kanë kohën përpara”, thoshte dje poeti Preç Zogaj.

Për studiuesin Ndue Ukaj, i kja e Fatos Arapit na tregon edhe njëherë sa shumë kemi nevojë për gjuhën fisnike të artit, të artit të bukur, që nuk dorëzohet përballë gjuhës së egër të atyre që helmatisin jetën me dokrra e marrëzi. “Poezia - kjo forcë magjike e magnetike, me gjuhën fisnike, na bën shtegtarë nëpër kohë e hapësirë

ISMAIL KADARE

“Pas ikjes së Dritëro Agollit, letërsia shqipe i ka gjithmonë e më të vështira humbjet e tjera, të dhimbshme si kjo e Fatos Arapit. Shkrimtar i rëndësishëm, me një jetë dhe krijimtari dramatike të shtrirë në dy epoka, Fatos Arapi, mik dhe koleg i dashur, u bë pjesë e pandarë e kalendarit letrar shqiptar të shekujve XX e XXI. Dëshmia e tij artistike do të jetë e veçantë dhe e çmuar në kronikën e gjatë të letërsisë shqipe”.

dhe na tregon ç’është e mirë dhe ç’është e keqe. Po, poezia është ilaçi i domosdoshëm për shpirt, për një shoqëri më humane, për t’i kuptuar betejet e ashpra të jetës, pra, për ta bërë jetën më të bukur dhe më humane, ashtu siç na ka treguar poeti i madh, Fatos Arapi dhe siç na tregon vargu kumbues ‘si s’është desha pak më shumë’; varg të cilin e shqipton secilla qenie njerëzore, në çaste humbjeje, gëzimi, dëshpërimi e mungese. Në fakt, ky varg buçet me forcën e madhështisë së fjalës, në zemrën e secilit lexues dhe e thërrret të drejtohet ka portat e dashurisë, për të dashuar pafund”. Për Ukajn, Arapi ishte poet i përkorë, që ka shkruar një poezi të ndierë, me një figuracion mbresëlënës, në të cilën



Petro Marko dhe Fatos Arapi

ndihen telat e zemrës së njeriut që e do njeriun, jetën, natyrën, paqen, atdheun, gjuhën, detin dhe çdo gjë të bukur, por që nuk dorëzohet as përballë shëmtisë... “Fatos Arapi është poet i madh, që i dha forcë poezisë shqipe. Me vargje të bukura ka kënaqur dhe lumturuar mijëra lexues dhe po ashtu, i ka tronditë mijëra lexues. Sepse, vargjet e tij, janë si ato buçeta të zgjedhura lulesh, që i mbajmë në duar përditë të shënuara, por edhe si muzikë e përmortshme, për ditë të hidhura. Po, lexuesi e ndien artin e tij dhe drithërimat shpërthyes, në çaste gëzimi e dëshpërimi, kur dërdëllitjet e shpirtit, e shpijnë njeriun në qiejt e lumturisë apo ato të dëshpërimit - në skëtetë. Dhe poeti, di që mjeshtërisht realitetet e jetës t’i kthejë në realitete estetike, që buçasin dhe lëshojnë tinguj të bukur, dashurie e dhimbje. E këto mund t’i bëjë vetëm një shpirt i madh, një talent i zoti, që drithërimat e jetës di t’i shndërojë në melodi, në këngë”, - shënonet Ukaj në ‘in memoriamin’ e tij. Poezia e Arapit të grish nga madhështia, dashuria e pakusht, nga natyra dhe gjuha fisnike. Po, ajo na thërrret, siç thërrasin kambanat e një katedrale madhështore, të hyjmë në të, të banojmë në të dhe ta ndiejmë peshën e artit madhështor, të korrit të jetës, të engjëjve që zbrasin në figura dhe na tregojnë rrugët e jetës.

“Ai la një varg veprash, dëshmi të një arti të madh dhe poezi antologjike, me të cilat ka gdhendë emrin e tij me shkronja të arta në letërsinë shqipe. Fatos Arapi, si askush, ka treguar ç’është atdheu, dhe si duhet t’i blatohej atij me dashuri pa kusht, ashtu siç i blatohej ai Tiranës që ka tiranë dhe që të vret: ‘Atdheu është dhimbje’.

“POETI QË S’TË LË VETËM”
“Kur një poet është i tillë, pra poet? Sipas meje, kur thotë gjërat që ti i ndjen e nuk arrin t’i thuasht, por sapo i lexon nga poeti, ndjehesh fill me shokë e jo vetëm. Se tekembra misioni më njerëzor i artit është mos me të lënë vetëm!”. Gjuhëtarja Ledi Shamku gjen tek artin e Arapit, një mik të mirë. Citon vargje të tij për të gjetur në to misionin njerëzor të përbushur: “Mbi rrogozin prej kashte./Ku netëve fle./ Shtrova/Dashurinë time.../ Po prap, brinjët t’i vret toka, plisi./ E prap i fortë është te



Poeti Xhevahir Spahiu

BOTIMI



koka/ Trungu prej lisi./ Hej, vend/ Plot diell e pa dritë!

Pagan dhe fron për perënditë!
"I shtrenjti Fatos poet e i shtrenjti Poet fatos, faleminderit nga shpirti që më lejove të bëhem shoqe me ty falë poezisë tënde. Faleminderit nga shpirti që shkrove në vetminë tënde dhe kështu theve vetminë time! Fushat e gjana të Elizit të pritshin sot siç pritët një poet: me grurë, me degë ulliri, me filad e me pjalm lulesh. Të desha fort!", shkruan Shamku.

SPAHIU NË LOT

Pas lajmit për ikjen e pakthyeshme të Arapit, vëmendja e lexuesve dje u mor edhe nga trishtimi i miqve të tij. Poeti Xhevahir Spahiu nuk i ka mbajtur lotët, kur ka lexuar lajmërimin e vdekjes së mikut ngjitur në një shtyllë. Kjo shkëputje e befte, kjo vënie para faktit të pakthyeshmë, që bërë më e rëndë për Spahiun, edhe sepse në një takim me të, më pat rrëfyer se që përpjekur disa herë ta takonte mikun e tij të hershëm. I binte portës së tij, por trokitjet mbeteshin shurdhe. I binte telefonit të tij, por nga ana tjetër nuk përgjigje njeri. Spahiu e kish marrë malli për shokun e rinisë e të poezisë, por në vitë nuk ia doli ta takonte, ndërsa Arapit kish zgjedhur të ndahet prej botës shumë më herët se vdekja ta detyronte. Imazhi i Spahiut të përloitur para njëjtimin në një shtyllë më kujtoi episodin që më rrëfente dhe takimin e pamundur. Ka qenë gazetari Zylyftar Hoxha, i cili ka fiksuar këtë moment të trishtit të poetit Spahiu, tekta shkruan: "Momenti kur Xhevahir Spahiu mëson vdekjen e mikut të tij, poetit Fatos Arapit". Xhevahir Spahiu nuk qan vetëm për humbjen e mikut të tij, por edhe për fundin e një gjenerate shkrimtarësh e poetësh, që me penën e tyre tejçuan shpirtit e gjithkujt dhe i dhanë ngjyra letërsisë shqipe.

FJALËT QË LA

"Dëgjoj shumë andej e këndeje pesimistë që flasin rreth letërsisë në përgjithësi dhe rreth poezisë. Por unë nuk jam pesimist. Unë mendoj se letërsia ecën. Po krijohen emra, po vijnë gjenerata të tjera dhe poezia nuk do të mbetet në mes të rrugës", që shprehur Arapit në një prej intervistave të fundit që dha. "Përkundrazi, - mendonte ai, - me traditën që është krijuar tanimë dhe me tendencat e

“Ne jemi fëmija e trupit tonë, një fëmijë që ka humbur pusullën”


Trupi është një shpikje e brezit tuaj, Lizon. Të paktën nga mënyra si e përdorni dhe si e ekspozoni atë. Por për sa u takon marrëdhëniet që mendja jonë mban me të si thes plot surpriza dhe si pompë jashtëqitjesh, sot heshtja është po aq e rëndë sa ishte në kohën time. Po ta këqyrnim me kujdes këtë çështje, do të vërejm që s'ka njerëz më të turpshëm sesa aktorët pornografikë më të zhveshur apo sesa artistët më të rruar e më të kruar të 'body art'it.

"Ditari i një trupi" i Daniel Pennac përkthyer nga Edmond Tupja është një rrëfim që ka të bëjë me peshesin, e gjatë sa vetë jeta, të pajtimt me trupin tonë, me këtë të huaj të brendshëm, që është njëkohësisht vetja jonë dhe një mister i përhershëm.

Ky roman nuk është si romanet e tjera, ai merr formën e ditarit të një njeriu të vetëm, përshkon gjithë jetën e tij, nga moshja 12-vjeçare deri në moshën 87-vjeçare, por nuk rrefen detajet biografike më themelore. Ai përqendrohet te trupi i rrefimtarit: trupi i tij fizik dhe jo personaliteti që e mbush atë, është heroi dhe subjekti i këtij libri. "Nëse do të më duhej ta botoja këtë ditar, do t'ua kushtoja së pari grave. Si këmbim, do të doja të lexoja ditarin që një grua do të kishte mbajtur për trupin e saj. Sa për të parë pak më qartë në mister-

“Ditari i një trupi”, vepra e përkthyer nga Edmond Tupja

in femëror. Ku qëndron ky mister? Në faktin, për shembull, se një burrë nuk di asgjë për atë çka ndien një grua lidhur me formën dhe peshën e gjinjve dhe se gratë nuk dinë asgjë për atë çka ndiejnë burrat lidhur me telashet që u nxjerr penisi", shkëpusim nga libri. Qëllimi i rrefimtarit ishte të vërente dhe të regjistronte të papriturat e shumta me të cilat na përball trupi ynë. Kështu, ai arriti të përshkuante gjithë evolucionin e organizimit të tij, por jo nga një pikë-pamje mjekësore apo anatomike, por në mënyrë intime, duke përfshirë në çdo faqe personazhe, situata, dialogë dhe mendime që na e bëjnë këtë trup të ngjashëm me tonin. Ne që ndihemi ndonjëherë kaq të vetmuar në trupin tonë, zbulojmë pak nga pak që ky kopsht sekret, në të vërtetë është një truall i përshkëlqet. Gjithçka që fshihim është shkruar këtu, e zezë në të bardhë dhe ajo që shpesh na frikëson, tashmë kthehet në hare. Sipas kritikës, rrefimtarit ia dorëzon ditarit të gjitha disfatat romantike, zaptimet seksuale dhe dëshitimet, nga fryma e parë tek e fundit. Kjo është shprehja e trupit nëpërmjet penës. "Mbetet jetësor fakti që nuk kemi thjesht një kole-



ksion fenomenesh fiziologjike, por një personazh, një zë, që na tërheq brenda... Pennac-u ka qenë gjithmonë një shkrimtar argëtues e njëkohësisht i aftë për të krijuar çaste bukurie të rrallë, që të lënë pa frymë, por më shumë se gjithë këto, ai është thjesht shkrimtari më njerëzor, më bujar dhe dashamirës ndaj gënieve të tjera njerëzore. Në "Ditari i një trupi" ka

gjetur një mënyrë të re dhe frymëzuese për ta treguar këtë", shkruan "The Guardian".

Për mediat franceze, libri është edhe "historia e fibrave tona, historia e njeriut që e nisi keq, vdiq e u ringjall mijëra herë dhe e mbushi jetën e tij", është njëherësh një rrëfim pa tabu që nuk mund të jetë i pacipë, pasi secilit prej nesh i flet veç për trupin e tij. "Culturebox Pennac-u përqafon tërësisht enigmën e ringjalljes, cila është lidhja midis meje dhe trupit tim? Dhe na tregon që misterin nuk shteron kur- rë", thuhet prej kritikës.

Autori Daniel Pennac ka shkruar më shumë se 31 vepra në të gjitha gjuhët, duke filluar nga albumet për fëmijë tek esetë, te librat me ilustrime, romanet dhe autobiografitë. Me veprën autobiografike "Chagrin d'ecole", botuar në 2007-ën, ai mori çmimin Renaudot. Hoqi dorë nga profesioni i mësuesit në vitin 1995, për t'iu përkushtuar tërësisht letërsisë. Në shqip është botuar romani i tij "Parasja e gogolëve" (Botime Pegi, 2012) dhe eseja e mirënjohur "Si një roman" (Botime Pegi, 2014).

Për autorin, sa më shumë e analizojmë këtë trup modern, sa më shumë e ekspozojmë, aq më pak ekziston ai. E shumëzgjimë me zero, në përpjesëtim të zhdrejtë me ekspozimin tij. Ne jemi deri në fund fëmija e trupit tonë. Një fëmijë që ka humbur pusullën".

Krijimtaria 50-vjeçare e Fatos Arapit në Fondet e Bibliotekës Kombëtare

Në shenjë homazhi dhe nderimi kushtuar poetit Fatos Arapit, i cili u nda nga jeta në moshën 89-vjeçare, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, çeli më datë 11 tetor ekspozitën "Homazh Fatos Arapit" (1930-2018).

Krijimtaria e botuar e Fatos Arapit zë fill në vitin 1962 me botimin e vëllimit të parë poetik "Shtigje poetike", për të vijuar më pas me një sërë vëllimesh poetike, tregime e novela dhe romane. E shtrirë në kohë, e larmishme për nga gjinitë dhe llojet letrare të lëvruara, e pasur dhe origjinale, krijimtaria e tij rreth 50-vjeçare përfshin: "Poema dhe vjersha" (1966); "Ritme të hekurta: vjersha dhe poema" (1968); "Patat e egra: novelë" (1970); "Dhjetori i shqetësuar: roman" (1970); "Kaltërsira" (1971); "Dikush më buzëqeshte: novelë" (1972); "Drejt qindra shekujsh

shkojmë: poema e vjersha" (1977); "Poezi" (1974); "Shokët: roman" (1977); "Fatet" (1979); "Deti në mes: roman" (1986); "Këngë të mocme shqiptare: studime" (1986), ribotuar edhe në vitin 2007; "Fjalë për poezinë: studime dhe artikuj" (1987) apo

"Duke dalë prej ëndrrës... poezi" (1989). Për të vijuar më pas me "Dafina nën shi" (1991); "Ku shkoni ju statuaja... poezi" (1990); "Ne, pikëllimi i dritave: poezi" (1993); "Unë vdiqa në brigjet e Jonit" (1993); "Çështja shqiptare dhe kriza ballkanike" (1996); "Ancient Albanian songs: studies" (1996); "In-tenebris... poezi" (1996); "Më vjen keq për Jagon: poezi" (1994); "Gloria victis: poezi" (1997); "Kujtohem që jam" (1997); "Më duhet një gjysmë ëndrrë: poezi" (1999); "Kush ishte Vllas Arapit" (2000); "Cipa e deborës: novela" (2000); "Gjeniu me kokë

të prerë" (2000); "Vëllezër hamletë: poezi" (2001); "Antologji personale" (2001); "Çështja shqiptare dhe kriza ballkanike" (2001); "Nuk shitet shpirti në tetor: novela" (2002); "Eklipsi i ëndrrës" (2002); "Ah, sikur të isha një përrallë: poezi" (2003); "Në Tiranë kur s'ke ç'të bësh...: tregime" (2003); "Shëtijet pa veten: poezi" (2005); "Horrat e ndershëm: tregime" (2007).

Në vitin 2014 është botuar pothuajse e gjithë krijimtaria e tij ndër vite në një përmbledhje poetike në katër vëllime: "Më jepni një emër: poezi të zgjedhura 1962-1989"; "Në kaq pak Tiranë: poezi të zgjedhura 1990-1996"; "Urna e vogël: poezi të zgjedhura 1997-2003" dhe "Një buzëqeshje e pabesueshme: poezi të zgjedhura 2005-2010". Fatos Arapit është marrë edhe

me përkthimin, duke sjellë në gjuhën shqipe "Vuajtjet e Vertier të ri" të J. W. Gëte botuar në Prishtinë, poezinë e Pablo Nerudës, Justo Jorge Padron, nga letërsia maqedonase Ante Popovskin, Mateja Matevski, si dhe

"Antologji e poezisë turke e shekullit XX".

Fatos Arapit lindi në Vlorë në vitin 1930. Kreu studimet e larta për ekonomi në Universitetin e Sofjes (1949-1954). Ka punuar si gazetar, pedagog, redaktor dhe shkrimtar në krijimtari të lirë. Ai nisi të shkruajë që në vitet e studimeve. Arapit i përket brezit të poetëve, që në vitet '60 sollën një mendim e figuracion të ri, duke e emancipuar poezinë shqipe nga rutina poetike dhe notat retorike.

shumëllojshme të larmishme që janë krijuar me një teknologji krejt të re, poezia do të shkojë përpara. Pastaj, fakti është që në përgjithësi letërsia shqiptare

tashmë e ka të qartë synimin e saj drejt lirisë së njeriut, drejt të drejtave njerëzore të njeriut, në përgjithësi, sigurisht të kombit shqiptar dhe të njeriut shqiptar,

në veçanti, mendoj se kjo letërsi është në rrugë të drejtë. Nuk duhet të jemi pesimistë. Unë jam optimist. Natyrisht, në moshën time dhe me sëmudjen që kam,

nuk mund t'i ndjek të gjithë, por jam optimist dhe ata ecin, ecin...". - thoshte Arapit, i cili 10 vite më parë pas një ishemie cerebrale, shënoi ndarjen me botën.

Opinion i Ditës

Roli global i SHBA dhe Perëndimit është i domosdoshëm

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

... real i tyre në garantimin e rendit botëror janë një fakt historik. Pas rrëzimit të komunizmit, SHBA në krye të Perëndimit, kanë dhënë kontribut efektiv e maksimal në garantimin e stabilitetit të rendit botëror. Në kushtet e sotme konstatohet një proces ndryshimi, përsosje e zhvillimit të ndjeshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare. Brenda këtij procesi sot evidentohej disa probleme apo fenomene, që lidhen me menaxhimin dhe udhëheqjen e zhvillimeve botërore, ku problemi i rolit global të SHBA dhe Perëndimit shfaqet gjithnjë e më i mprehtë. Tash ka edhe analistë që flasin për një tërheqje të SHBA nga roli botëror. SHBA dhe Perëndimi kanë qenë realisht garantuesit kryesorë të sigurisë dhe stabilitetit të rendit botëror, prandaj edhe disa lëvizje e zhvillime kanë një sensibilitet të lartë.

Jo vetëm një dalje e dallueshme e Rusisë dhe Kinës, sa i përket rolit të tyre në zhvillimet botërore e rivalitetit të tyre apo ndarjes së rolit me SHBA, por bëhen më të mprehta, por tërheqjen vëmendjen edhe disa lëvizje e zhvillimeve brenda Perëndimit. Evidentohej një grumbim reale brenda Perëndimit, jo vetëm për tarifën e vendosur në tregtimin e aluminit, që ka rritur shqetësimet rreth rolit global të Perëndimit e liderit të Perëndimit, SHBA, në udhëheqjen botërore. Disa lëvizje të SHBA si, kritikant ndaj aleatëve për kontributet financiare për çështjet e sigurisë, tërheqja nga traktati për klimën dhe marrëveshja për bërthamën e Iranin, apo grindja në samitin e G7, por edhe fjala e presidentit amerikan në sesionin e fundit të OKB janë interpretuar se tash do funksionojë koncepti "secili në rrugën e vet".

Në funksion të strategjisë së Rusisë dhe Kinës për rol botëror e ndarje të fuqisë e rolit me SHBA, të një rivaliteti në rritje, kuptohen edhe pohimet prej tyre të tipit teorik, për fundin e rendit botëror liberal, që nënkupton edhe fundin e rolit udhëheqës global të SHBA dhe Perëndimit. Megjithatë, ka sot edhe analiza e botime konkrete, që fokusohen te kjo çështje, ku përcillen edhe mendime apo opsione. Jo vetëm të tipit se po krijohet një rend i ri botëror, apo se demokracia liberale e rendi botëror liberal tashmë kanë përfunduar, por edhe ide të tipit se SHBA të janë tërhequr nga udhëheqja globale apo do të tërhiqen, apo koncepti që mendon se tashmë SHBA dhe BE janë më shumë rivale se aleate, apo se tashmë është shkatërruar Perëndimi i vjetër etj. Robert Kagan në librin e tij "Rikthimi i xhunglës" mendon se SHBA është tërhequr si garantuese e rendit botëror, që i formua pas Luftës së Dytë Botërore. Bota po kthehet në gjendjen e saj natyrore dmth., në një xhungël të errët me interesa konkurruese, ku përplasen nacionalizmi, tribalizmi dhe interesi vetjak. Kështu, rendi botëror liberal i krijuar nga SHBA, pak më shumë se shtatë dekada më parë, është duke u shembur. Sipas tij, SHBA duket e lodhur dhe e



rraskapitur nga barra e problemeve globale. Edhe politikanë evropianë si ministri gjerman Heiko Mass pohon se rendi aktual ndërkombëtar, i bazuar në rregulla po gërryvet, në një botë ku asgjë nuk mund të merret si e mirëqenë në politikën e jashtme.

Po kështu, në kushtet e avancimit të grindjes mes SHBA dhe BE mësohet reagimi nga Gjermania përmes Sigmar Gabriel, që mendon se bota po ndryshon në mënyrë dramatike dhe ne gjermanët rrezikohemi t'i nënvlefësojmë pasojat. Gabriel, sjelljen e SHBA nën drejtimin e presidentit Trump e sheh si një shkak për atë që e evidenton se "është shkatërruar Perëndimi i vjetër". Sipas tij, pas 70 vjetësh të rolit të SHBA të garantit të sigurisë, stabilitetit e paqes në botë, tash duket se është prezantuar ideja "secili në rrugën e vet". Ai tregohet i kujdesshëm teksa pikturon rolin e Gjermanisë brenda këtyre ndryshimeve, teksa kërkon maturi e ekuilibër në formën që, Gjermania nuk duhet të transformohet nga një abstenuese gjeopolitike në një geostrategjistë me ndikim.

Ai kërkon një debat të brendshëm që do t'i shërbente përcaktimit të një statusi, qëndrimit apo rolit të Gjermanisë në zhvillimet botërore. Për shumë arsye mendon ai, Gjermania nuk mund të qëndrojë mënjamë, as të bëhet një Zvicër e dytë në Europë. Megjithatë, ai sheh si shumë të rëndësishme, që të bëhet aktive e funksionuese një politikë e jashtme e BE, edhe pse kjo aktualisht po duket e vështirë. Gjithsesi, ai insiston se po pëqet nevoja për lideret evropianë që të mendojnë më shumë për veten, për Europën, që ta mendojnë dhe një rol të saj në zhvillimet botërore. Ai evidenton më të drejtë rolin e dallueshëm të Gjermanisë në mbrojtjen e sistemit të vlerave dhe ndërmarrje të veprimeve në përpunje me të në rastin e përballjes me krizën e refugjatëve. Ai i relativizon frikërat e donojë për atë që mund të vlerësohet si rritje e pushtetit të Gjermanisë në vendimarrjen evropiane. Dhe është fakt, që Gjermania ka mbajtur një peshe të madhe në përballimin e krizës në hapësirën e BE e sidomos të përballimit të krizës greke, por edhe në trajtimin e një problematike të mprehtë e komplekse brenda BE, duke

baraspeshuar ligjin, marrëveshjet e rregullat e dakordësuara dhe mençurinë, që është vlerësuar nga anëtarët e tjerë të bashkësisë evropiane.

Ka sot ngas ata që mendojnë se brenda procesit të përsosjes së marrëdhënies perëndimore, po duket sikur SHBA dhe BE kanë prirje të shfaqen më shumë si rivale se sa aleatë, apo që shihen dhe si akuzë se SHBA po e sheh Europën më shumë rivale, apo që e mendojnë një kthesë apo ndryshim esencial të marrëdhënies perëndimore, ku me më shumë shqetësim shihen çështja e rolit global të SHBA, duke përcjellë mendimin, që BE duhet të përgatitet për këtë ndryshim të marrëdhënies me SHBA Jo vetëm në fushën e sigurisë, por edhe më gjerë. Disa tregohen tepër të shqetësuar për atë që e vlerësojnë si shkuarjes të Europës, që përballtet me një problematikë komplekse të brendshme, ku janë bërë shqetësues edhe prijret nacionaliste, sovraniste, populiste e euroskeptike. Madje, Kagan mendon se, e frustuar nga populizmi dhe politika e identitetit, Europa është në rrezik të kthehet në grindjet, që prodhuan totalitarizmin në vitet '30 të shekullit të kaluar. Madje, Kagan sheh si një çështje të mprehtë jo Lindjen e Mesme, as Rusinë dhe Kinën, por ardhmërinë e situatës në Europë. Është ky një mendim individual e shqetësim i tillë, por që nuk përjashton nevojën për një reflektim serioz e kompleks. Kujtesa historike ka rëndësi në vet për reflektim e përgjegjshmëri, për reagim e ndryshim të situatës, por çdo ngjarje është produkt i kushteve e zhvillimeve konkrete dhe se historia nuk mund të përsëritet dy herë njëllë.

Kuptohet që në këto kushte, nevojitet analizë e përqendruar, e thellë dhe e gjithanshme, që të mos gabosh në në konkluzione e as në reagime. Natyrisht që konstatohet një ndryshim e përsosje e marrëdhënies perëndimore, e elementeve përbërës të saj, rregullave, raporteve e pozicioneve konkrete dhe kjo është brenda një normaliteti zhvillimi. Kushtet e rrethanat brenda e jashtë marrëdhënies përbëjnë shkak e impuls për ndryshim e përsosje. Dhe kjo nuk mund të përjashtohet as në përsosjen e marrëdhënies perëndimore, që do të sjellë produkte e energji të reja

dhe që do të bëjnë më efektiv e aktiv rolin e SHBA dhe Perëndimit në zhvillimet botërore. Kjo përsosje do të mundësojë edhe kontribut, angazhim e rol më të madh, jo vetëm të SHBA, por edhe të anëtarëve të BE. Nuk ka argumente shumë bindëse që të bëjnë të mendosh me siguri një prirje për abdikim të SHBA, sa i përket lidershitit ndërkombëtar. Në kushtet e një shqetësimi të shtuar për zhvillimet brenda Perëndimit, ka edhe nga ata që shohin apo bëjnë thirrje për formate të tipit G-9, ku përfshihen Britaninë, Francën, Gjermaninë, Italinë, Australinë, Korenë e Jugut, Japoninë, Kënanë dhe BE, që e mendojnë se do të kontribuonte, jo vetëm për një tregti botërore në zhvillim, por edhe për përballimin e krizave të vështira. Po kështu, konstatohet se Kina edhe pse është anëtarësuar në institucione të rëndësishme ndërkombëtare, shfaqet si fuqi revizioniste. Ajo me lëvizje konkrete ka sfiduar institucionet e sigurisë në rajonin e Paqësorit, apo normat territoriale në detin e Kinës Jugore, por edhe ka ngritur institucione alternative si Banka Aziatike e Investimeve në Indonezi, trukturë apo dhe Nisma e Brezitetit të Rugëve. Në strategjinë e mbrojtjes së SHBA mendohet se Kina dhe Rusia dëshirojnë të formojnë një botë në përpunje me modelin e tyre autoritar. Po kështu edhe Rusia ka krijuar dy organizma euroaziatikë ekonomikë e ushtarakë. Të dyja këto vende janë pjesë e formatit të BRIKS. Historia e linjës revizioniste dëshmon se fuqitë revizioniste synojnë të minojnë statuskuonë, edhe pse mbajnë lidhje me institucionet ndërkombëtare. Kjo i ndihmon fuqitë revizioniste të ndjekin qëllimet e tyre, duke u përpjekur edhe për të kërkuar reforma brenda këtyre institucioneve.

Disa analistë mendojnë sot se, ka gjasa që Kina të zgjerojë ambicet e saj, nëse SHBA do të ecin në rrugën e tërheqjes nga drejtimi i rendit global. Kur ka proces ndryshimi, jo të gjithë e shohin e interretojnë dhe e kuptojnë njëllë. Kjo krijon edhe shqetësim, por edhe nxitim për të formuluar konkluzione shpesh jo të argumentuara bindshëm. Në kushte krizash apo ndryshimesh, të përgatitura nga evolucioni, lindin edhe frikëra, por edhe mendime konkrete ndryshuese, por rëndësi ka njohta reale e shkencore e zhvillimeve. Kështu, edhe pse disa flasin sot për një ndryshim të qëndrimit amerikan drejt një roli "post imperial" nuk mund të paragjykohej asnjë ide e shprehur apo kërkesë për ndryshim të situatës.

Pas rrëzimit të komunizmit pritej që të ndodhte ndryshimi apo përsosja e përmbytjes së marrëdhënies perëndimore e përmbytjes së rolit udhëheqës së perëndimit në zhvillimet globale. Dhe në fakt, edhe formati Perëndim, i strukturuar gjatë përballjes me komunizmin dhe vetë marrëdhënia perëndimore në vetvetë, do të hynte e hyri në këtë proces reformimi apo ndryshimi. Ai po ndodh e po realizohet tani, prandaj dhe nuk duhet ngutur në konkluzione. Shqetësimi ka lindur ndoshta, se nuk është bërë prezent donjë strategji, program, projekt apo vizion i paramenduar apo i stu-

diuar më parë. Ky proces ndryshimi apo përsosjeje, po ndodh në kushtet kur brenda BE është evidencuar një problematikë konkrete, e krijuar edhe nga një ngecje e ecurisë së projektit evropian, por edhe nga një rritjeje e ndjeshme e dallgëve të nacionalizmit e sovranizmit, por edhe nga pasojat e shkaktuara nga kriza botërore e financiare e vitit 2008. Edhe brenda SHBA, duket që ka një problematikë të brendshme, që dikton kërkesën ndaj SHBA, që të merret edhe më shumë me veten, në përballimin e një problematike komplekse, të shkaktuara edhe nga kriza botërore financiare, por edhe faktorë të tjerë. Këto rrethanat e ndihmojnë të kuptohen më drejt edhe disa deklarime e qëndrime të SHBA e të presidentit amerikan Trump. Duket që Perëndimi është kthyer nga vetvetja, nga përsosja e shumë elementeve brenda vetes, për të riparuar konsumimet e mundshme, por edhe për të bërë përmirëtimet e nevojshme. Në këtë moment kur Perëndimi po merret me vetveten, ka krijuar shqetësimin apo mendimin se mund të ketë rishikim e ndryshim të rolit global të SHBA dhe Perëndimit. Në fakt po shihen korrekte, reflektive apo përpjekje për një përballim të problemeve të pashmangshme brenda vetes dhe për të mundësuar një rritje të efektivitetit të rolit të tyre në zhvillimet globale dhe udhëheqjen e tyre.

Roli udhëheqës i SHBA dhe Perëndimit në zhvillimet globale ka qenë dhe është një domosdoshmëri objektive. Kjo nevojë apo domosdoshmëri ka një përmbajtje konkrete, që përfshin të vërtetën objektive, nevojën historike të rolit udhëheqës dhe mundësinë reale të realizimit të tij. SHBA dhe Perëndimi mishëron aktualisht modelin më të avancuar të zhvillimit në botën e sotme, që ka në themel të tij sistemin e vlerave, jo thjesht si parullë apo kornizë, por si një realitet në veprim. Ky model sot është në fakt më i lartë e më i arriri deri më sot, është modeli për t'u arritur e materializuar, është qëllim e mundësi shprehë për njerëzit e popujt që aspirojnë liri, demokraci, prosperitet e dinjitet njerëzor, zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt.

SHBA dhe Perëndimi kanë mundësitë komplekse që e mundëson dhe e kërkon këtë rol udhëheqës, sepse jo vetëm përfaqësojnë modelin më të lartë të zhvillimit ekonomik, politik e social sot, por përbëjnë fuqinë më të madhe ekonomike e ushtarakë në botë: se kanë epërsinë globale në teknologji e inovacion, përvojën e pasur dhe metodologjinë më të përsosur në njohjen dhe përballimin e problemeve e krizave të shumëllojshme; sepse kanë qenë e janë mbrojtës aktiv të jetës njerëzore e njerëzimit, të sistemit të vlerave; sepse kanë qenë dhe janë aktori e faktor i qendër në përballimin e krizave nga më të vështirat dhe mbrojtësit e garantuesit efektiv të sigurisë, stabilitetit e paqes në botë; sepse kanë besueshmërinë, vizionin dhe filozofinë më të mirë të bashkëpunimit dhe se kanë krijuar një mendim e eksperiencë krijuar në respektimin e mbrojtjen e ligjit e të drejtës ndërkombëtare, se kanë krijuar besimin dhe shpresën në nivelin më të lartë në botë.

Opinioni **i** Ditës

Kur ikin shkrimtarët...

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

.... Shkrimtari vetëm ikën, nuk vdes. Fatos Arapi ishte dhe do të mbetet një nga poetët më të shquar të letërsisë shqipe. Fatos Arapi e ndezi pishtarin e poezisë së tij kur poezia shqipe ishte në gjysmërrë-sirën e saj... I ri, simpatik, plot ëndërta kthehet nga studimet e tij, nga Bullgaria. Shumë shpejt do të paraqitet para lexuesit me librin e tij "Shtigje poetike" dhe shumë shpejt kritika letrare e asaj kohe do ta rendiste në treshen poetike, në kostelacionin e ri të poezisë shqipe: Kadare-Agolli-Arapi... Ky konstelacion i poezisë shqipe do të ndriste mbi Shqipërinë e vogël, e rrethuar me gjemba dhe të mbyl-lur nga bota, për tri dekada.

Tashmë, kur shkruaj këto rreshta, ndjej trishtim të madh dhe një boshllëk në shpirt si shumëkush që e ka njohur dhe e ka pasur mik Fatosin, edhe si i gjithë brezi i ri i viteve gjashtëdhjetë, që u rrit me poezitë e tij dhe me emrin e tij në gojë...

Lamtumirë, profesori ynë i nderuar i fakultetit, lamtumirë, mik, shok, vëlla, Fatos! Kështu të thërrisnin në fëmijëri... Kështu të kemi thirrur të gjithë ne dikur, me dashuri, kështu e kishe poezinë dhe shpirtin, djaloshar.

Fillimisht Fatosin e kemi njohur si profesor i lëndës së ekonomisë politike... Një profesor si aktor filmash, simpatik, me një temperament të veçantë, poetik. Pas orëve të mësimi, ai nuk ishte më profesori ynë, profesori i Minush Jeros, Musa Vyshkës, Vath Korëshit, Helena Kadesës, Ruzhdi Pulahës, Sadije Agollit, por ishte thjesht mikun ynë i veçantë, që na vizitonte në konviktet tona dhe polemizonte me ne, me zjarr, për çështjet e letërsisë... Më vonë, me Fatosin do të kalonim një jetë të gjatë. Si koleg pune, në Lidhjen e Shkrimtarëve... Kujtimet janë të shumta, por ajo që e forcoi miqësinë tonë dhe më tepër ishte aksidenti automobilistik që na ndodhi në dhe familjeve tona, në hyrje të Sarandës. Viti 1968, Fatosi u shtrua në spitalin e Sarandës për dy muaj... Shpëtuam mirë. Pjesa tjetër e jeta që do të vazhdonte do të na quhej jetë e dytë... Kujtimet me Fatosin janë të shumta, por më emocionueset dhe më të paharueshmet kemi pasur ditët e rrethimit të poezisë së Gjakovës. Viti 1878. Në ato vite ishte rast i rrallë, por dhe fat i madh që dy poetë nga Shqipëria të marrnin pjesë në një festival Ballkanik në Kosovë. Nga këto 15 ditë që jetuam së bashku midis vëllezërve kosovarë, Fatosi ishte shumë emocional. Prekej shpejt... Sidomos mbrëmjeve kur i kujtohej vëllai i tij Vilasi, që i kishte vdekur para kohe. Kur poeti Fatos Arapi përshëndeti publikun kosovar me fjalët "Të fala nga Vlora", u ngrit i gjithë publiku në këmbë dhe u një ulërimë kaq e madhe, pasuar me fishkëllima dhe zëra që nuk e



përmbanin dot gëzimin për praninë e poetit nga Vlora, të cilën, në bisedat tona do ta quanin "Jerusalem-in e shqiptarëve". Në kthim, në kufijtë e dy shteteve të ndarë padrejtësisht nga viti i mallkuar 1913, pamë një ngjarje të pazakontë. Shqiptarë nga të dyja anët e kufirit. Në largësi. Merreshin vesh me gishta dhe shamë të lëkundura në erë... Në atë çast Fatosin e mbyti ngashërimi... Shkuam dhe i takuam anëtarët e familjes nga ana e kufirit malazes, Fatosi u premtoi se sa të kalonim kufirin, do t'i takonim pjesëtarët e fisit të tyre. Dhe ashtu bëmë...

Fatosi iku. Fatosi nuk është më... Por ai e ka lënë veprën e tij të madhe, në poezi dhe në prozë, në dramë dhe në kujtimin e gjithë atij brezi, që është rritur me poezitë e poetit të madh. Ndaj, tani them se ndryshe nga të tjerët, poetët vetëm ikin, por nuk vdesin. Poetët e mëdhenj si Fatos Arapi i përkasin kujtesës së kombit... Ata mbeten në piedestalin e këtij kombi... I dashur Fatos! Ti i dhe shumë dashuri këtij vendi, por qeveritarët që e kanë qeverisur këtë vend të dhanë pak dashuri, pak respekt dhe aspak përkujdesje, as ty, as krijimtarisë sate. Ti ishe i vetëdijshëm për këtë gjë. Ti e dije se kjo gjë nuk ndodhte vetëm me ty, por edhe me shumë shkrimtarë dhe artistë të tjerë. Se kjo shpërfilloje nuk fillonte me ty dhe nuk mbaron me emrin tënd... Ti e dije se në vendin e vet nuk nderohen poetët... Lamtumirë o më i madh poeti i madh i viseve Jonike!

Atdheu është dhimbje, është dhimbje. Një prill i pikëlluar në shpirt. Atdheu është kryqi, është kryqi.

E mban... dhe të mban ty në

shpirt.

Atdheu është varr i hapur, është varr. Një jetë drejt tij shkon me besë që lind. Një pikë loti mbyl lotin fatvuarë, Një pikë loti lirinë lind.

Atdheu yt, i vogli, i vogli... Si hyjori, i pavdekshmi, si loti. Fatos Arapi i kushtoi jetën poezisë, e cila kohët e fundit u përmblohd dhe u botua në këtë vëllim poetik... Poezia e tij metaforike është një koncentrat i mendimit të lirë dhe i lirikës filozofike, që buron nga peizazhi shqiptar i tokës që e lindti... Zvërneci, vendlindja e tij, është një nga fshatrat më të bukur të Ballkanit. Të tillë fat kishte poeti. Të ishte biri i kësaj vendlindjeje dhe të mbarhte me vete reflekte të peizazheve jonike, të cilat e bënë poezinë e tij sa brilante, aq edhe të veçantë... Poezia "Deti" e Fatos Arapit është një perlë e papërsëritur e poezisë shqipe, ku Zvërneci dhe shpirti i tij lirik piqen në një pikë...

"Poeti Fatos Arapi, - shkruan publicisti Azis Gjergji - lindi duke shpresuar, u burrërua duke thirrur dhe u plak duke dërdhur lot mbi komunikimin shqiptar, që kishte lindur i vdekur".

"Nga sot e tutje atje në Zvërnecin e tij, Hëna do të shëtisë e trishtë", shkruan në 'FB' poeti dhe bashkëfshatari i tij, Jani Malo... dhe "pulëbardhat në fluturim do të shkruajnë metaforat e pathënë të Arapit".

Qysh me librin e tij të parë "Shtigje poetike", Arapi do të publikonte kredon e tij poetike: Unë nuk erdha në jetë që të lus

perënditë që profetët e mykur mësonjës t'i kem, Unë erdha në jetë që t'i blatoj, këngë të gëzuara mejtimit të lirë... Poezia e Fatos Arapit është kënga e lirë e njeriut të lirë, një poezi entuziaste, e fuqishme, optimiste, me figuracion të veçantë dhe shërthyes... Poeti Preç Zogaj e cilëson Fatosin "si një Sovran i poezisë, që ka përndritur rininë e tij dhe ka modeluar konceptet e tij për të bukurën". Lavdi guximit të heshtjes! Ky varg më së shumti do t'i shkonte vetëm poetit Fatos Arapi, i cili për dy dekada e sfidoi kohën me heshtjen e vet... Ndërkohë, shkrimtarët të tjerë përpunojnë opinionin për ladinë e tyre gjatë gjithë jetës, Fatos Arapi bëri tri dekada që e lartësoi veten me heshtjen dinjitoze, prej shkrimtari, duke qenë i vetëdijshëm për vlerat e krijimtarisë së tij...

Në fillim të viteve nëntëdhjetë, Arapi u rreshtua përkrah disa intelektualëve që luftonin për një demokraci të vërtetë. Por, me intuitën e vet prej shkrimtari, ai e kuptoi shpejt se në Shqipëri kjo demokraci e vërtetë do të vnohej, ndaj dhe heshti. Arapi nuk ka qenë asnjëherë anëtar partie. Kështu që ai nuk ka dashur t'i gëzojë frytet partiake që u janë afruar disa intelektualëve... Fatos Arapi i mbeti besnik krijimtarisë së tij të veçantë si një intelektual i vërtetë dhe i pavarur, ai i mbeti besnik i parimeve njerëzore, jo vetëm në krijimtarinë, por edhe në jetën e përditshme. Arapi ka vlera të veçanta, si intelektual i pavarur dhe si një opozitar i heshtur, ndaj ai do të mbetet gjatë në kujtesën tonë.

HOROSKOPI

- DASHI**
 Do të ndiheni shumë mirë nëse ndani lumturinë tuaj me të tjerët. Dikush me të cilin jetoni mund të mërzitet për shkak të moskryerjes së detyrave që ju takojnë. Mund të krijoni një lidhje të re dashurie, por mos zbuloni informacione që janë personale dhe konfidenciale.
- DEMI**
 Do të realizoni një udhëtim, të cilin keni kohë që e planifikoni. Pavarësisht agjendës së ngarkuar, do ta përballoni lodhjen. Do të përballeni me një ndërç financiar, por do të dilni prej tij pas mbështetjes së të afërmeve tuaj.
- BINJAKET**
 Sensi juaj i humorit do të ndihmojë një mikun tuaj të dalë nga pesimizmi. Përmirësimi i financave do t'ju bëjë që të bëni disa blerje të rëndësishme. Përpunimi të përkushtoheni sa më shumë ndaj partnerit, duke e bërë këtë ditë të paharueshme.
- GAFORJA**
 Presioni në punë dhe në shtëpi do t'ju bëjë të humbisni durimin. Mund të mos e besoni, por një person shumë afër jush po ju vëzhgon, pasi ju sheh si model gjë që do t'ju rritë reputacionin. Madje, sot shumë persona do t'ju komplimentojnë.
- LUANI**
 Tregohuni optimist dhe shikoni anën e mirë të gjërave. Është koha e duhur që të hidhni një hap të rëndësishëm si martesë. Mund të takoheni me një mik që keni kohë pa e parë. Kushitoni më shumë rëndësi punës dhe prioriteteve tuaja.
- VIRGJERESHA**
 Nuk do të jeni shumë të qëndrueshëm emocionalisht, ndaj bëni kujdes me sjelljen. Merrni mendim e anëtarëve të familjes para se të finalizoni diçka. Vendimet tuaja të njëanshme mund të krijojnë probleme. Përpunimi të krijoni harmoni në familje, në mënyrë që të arrini rezultatet e kërkuara.
- PESHORJA**
 Përpunimi të mos shpenzoni shumë për t'u argëtuar apo për lukan tuaj. Ndërrhyrja në punët e partnerit/partneres mund të përkëqesojë situatën mes jush. Përpunimi të kushtoni më shumë rëndësi të dashurit të zemrës. Një nga të afërmit tuaj mund t'ju surprizojë sot.
- AKREPI**
 Është e nevojshme të relaksoheni për të fituar energjitë e humbura. Bëni mirë të dilni me miqtë e ngushtë, të cilët kuptojnë plotësisht problemet tuaja. Sa i përket anës romantike, do të jetë një ditë e ndërlikuar.
- SHIGJETARI**
 Shmangni ushqimet pikante dhe të yndyrshme. Kontrolloni tendencën për të jetuar momentin dhe për të shpenzuar shumë para për argëtim. Bashkëpunoni dhe flisni me familjarët tuaj që të jetoni në harmoni.
- BRICJAPI**
 Është e rëndësishme të qetësoheni dhe të largoni stresin, pasi do të ndikojë negativisht në shëndetin tuaj. Përdorni fuqinë tuaj profesionale për të ecur edhe më tej në karrierë. Partneri/partnerja juaj do të tregohet shumë romantik/e sot.
- UJORI**
 Përdorini energjitë tuaja aty ku duhet. Është dita e duhur për të investuar aty ku e kishit menduar. Partneri/partnerja juaj do të kërkojë më shumë përkushtim prej jush. Përpunimi të mos bëni komente të ashpura, pasi mund të përfshihen në konflikt.
- PESHQIT**
 Keqepëdorimi i marrëdhënieve personale për të pëmbushur pritshmëritë tuaja mund të shkaktojë një situatë shumë të pakëndësishme. Duhet të relaksoheni dhe të gjeni lumturinë mes familjarëve dhe miqve tuaj të ngushtë. Teksa keni kaluar disa ditë të tensionuara në punë,

Shqipëria duhet të sudhëtojë e shqetësuar drejt Izraelit këtë fundjavë pasi gjen përpara një skuadër krejt ndryshe nga ajo që u përballëm në Elbasan. Kjo vjen nga fakti se izraelitët e Hercog kanë gjetur sot fitoren e parë ndaj Skocisë, për më tepër me përmbysje, duke marrë një sukses që hap plotësisht grupin, duke ulur



Shqipëria e dënuar të fitojë në Haifa

Izraeli përmbys Skocinë dhe merr vendin e parë në grup.

Shqipërinë në vendin e fundit. Skocezët ishin favoritët për të marrë një sukses, por në fillimin e ndeshjes izraelitët krijuan më shumë raste shënimi, derisa një penalti e dyshimtë i dha avantazhin

miqve. Mullgrju nuk gaboi nga pika e bardhë dhe kaloi Skocinë përpara. Por izraelitët nuk hoqën dorë nga sulmet dhe kërkuan me ngulm golin që erdhi në fillimin e pjesës së dytë me Peretz. Më pas, kartoni i

kuq i Sutar në radhët e skocezëve bëri më të thjeshtë punën e izraelitëve, të cilët gjetën rrjetin me anë të një autogoli të Tiernei, duke i dhënë mundësinë izraelitëve të përmbysin plotësisht rezultatit. Asgjë

nuk ndryshoi deri në vërsëllimën përfundimtare dhe kjo i dha mundësinë Izraelit të merrte pikët e para në grup, duke bërë që të tre skuadrat të kishin të njëjtën kuotë pas 2 ndeshjeve të luajtura. Golavarazhi më i dobët, 1-2, bën që tashmë të jetë Shqipëria ajo që mban vendin e fundit, por mund të marrë kreun të dielën me një sukses në fushën kundërshtare.

Mbrojtësi i Napolit mbyll debatin me Panuçin: Trajneri më kurseu ndaj Jordanisë



Jeton Selimi

Hysaj: Ndaj Izraelit do të japim 120%

Shkodrani ndjen mungesën e sulmuesit në ekip

Skuadra përfaqësuese e futbollit tashmë ka nisur përgatitjet e saj për ndeshjen shumë të rëndësishme ndaj Izraelit. Përballja zyrtare eliminator e së dielës, e cila do të ketë një rëndësi të jashtëzakonshme për vetë pozitat në grup. Nga ana tjetër, një fitore është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme në këtë moment për ekipin. Përpara mediave dje dolën futbollistët Elseid Hysaj dhe Migjen Basha. Të dy ishin pushim në takimin me Jordaninë, dhe tashmë janë një forcë më shumë për trajnerin, për sfidën e së dielës. Mbrojtësi Hysaj për mediat theksoi: **Panuçi tha se e kurseva Hysajn, pasi kishte shumë ndeshje. E kemi ndërjerë peshën e këtyre minutave?** Trajneri ka të drejtë, pasi te Napoli kemi pasur shumë ndeshje këtë periudhë. Duhet të luajnë edhe të rinjtë, pasi në këto ndeshje duhen parë edhe ata. Bëri mirë që disa lojtarë i la pushim.



Ndaj Jordanisë u ndje mungesa e krosimeve tua... Lojtarët që ishin dje luajtën mirë. Të dielën, unë do jap maksimumin, të luajmë mirë dhe të bëjmë ndonjë

gol për të vazhduar rrugën tonë. Besoj se ndaj Izraelit mund t'ia dalim. Dje ishte e vështirë, Jordania u mbyll, por treguam karakter. Punë centimetrash nuk

hyri goli. **Keni qenë në fushë kur fituam 0-3 në Izrael. Ku ndryshon kjo Kombëtare?** Fituam 0-3, por vinim edhe nga humbja me Luksem-

burgun. Të njëjtët lojtarë jemi, ndryshime nuk ka shumë, besoj se jemi gati për të luajtur ndeshjen. **A është ende e paqartë skuadra?** Jemi lojtarë profesionistë, ne nuk është se çmendemi në lojë kur na ndryshojnë pak taktikën. Të gjithë luajmë në kampionate të mëdhenj. Thjesht, na duhen 2-3 ditë që të kuptojmë si të japim më të mirën në fushë. **Cikalleshi, Sadiku, disa mungesa në sulm. A ndihen?** Ata janë lojtarë të mirë, dihet që na mungojnë, por ka edhe tani lojtarë që mund të bëjnë mirë, dhe e kanë treguar veten edhe atje ku luajmë. Çdokush që do luajë do japë 120% të tij në fushë, pasi na duhet të fitojmë.

MESFUSHORI I ARIST



Basha: **Kemi besim te vetja jonë** Mesfushori Basha nuk ka asnjë dyshim që kjo skuadër mund të japë sërish emocione të forta: "Sigurisht që ky grup që jemi mund të vijojë me sukseset e tij. Tashmë ajo që na intereson është përballja e së dielës. Ndaj Izraelit duhet të japim maksimumin tonë. Ne lojtarët, jemi ata që duhet të ngremë moralin. Duhet entuziazëm, dhe të luajmë si një finale, pasi kjo ndeshje do vendosë fatet tona në grup. Nëse bëjmë një rezultat të mirë atje, kemi shumë shanse për më tej. Kemi besim dhe të gjithë bashkë do t'ia dalim", - theksoi Basha, që së bashku me Elseid Hysajn, janë përzgjedhur nga skuadra si dy zvkapitenët e ekipit.

LIGA E KOMBEVE

Kosova thyen Maltën dhe merr kreun e grupit

Kosova bëri një ndeshje të shkëlqyer kundër Maltës, duke i mposhtur këta të fundit me rezultatit 3-1. Djemtë e Shaland e nisën takimin në mënyrë perfekte, duke rrezikuar portën e skuadrës modeste që në sekondat e para. Pas shumë tentativave, Kolloli gjen më në fund rrjetin, pasi në minutën e 30' ndëshkon portierin Hog. Zhegrova kishte rastin më të mirë për të dyfishuar, por goditja e tij në minutën e 41' u përplas në shtyllë. Pjesa e parë u mbyll në avantazhin 1-0 të



Kosovës dhe u duk se kishin një ndeshje shumë të lehtë, por Malta barazoi në startin e pjesës së dytë. Agius barazoi në minutën e 51', duke

detyruar Kosovën të punojë për të gjetur sërish avantazhin. Në minutën e 65', Zhegrova ndalet sërish nga shtylla, ndërsa 3 minuta më vonë, Muriqi rikthen avantazhin dhe qetësinë në kampion kosovar. Aktivizimi i Rashicës në minutën e 76', shtohet rrezikshmëria në sulmin e Kosovës dhe ishte pikërisht një pasim i Rashicës që solli golin e tretë, të shënuar nga Kolloli. Mbrojtësi i majtë realizon golin e dytë personal dhe Kosova merr një fitore 3-1, që e mban në krye të grupit.

KOMBËTARJA U-21

Spanja mposht minimalisht Shqipërinë


Përfaqësuesja U-21 e Shqipërisë e drejtuar nga trajneri Alban Bushi është mundur minimalisht nga Spanja 0-1 në ndeshjen e vlefshme eliminatorë për Europeanin që u zhvillua gjatë ditës së shtunë në stadiumin "Selman Stërmasi" në Tiranë. Ndeshja ka qenë në një nivel të mire, por pa mundur të marrim një rezultat pozitiv. Pjesa e parë ka përfunduar me rezultatin e bardhë 0-0 dhe goli i vetëm i kësaj ndeshje u shënuar në minutën e 84-t nga Rafael Mir. Shqipëria e filloi ndeshjen me këtë formacion: Kastrati, Maloku, Toli, Tafa, Kryeziu, Laçi (88? Sahiti), Bare, Doka, Muçol-



li (67? Mala), Seferi (83? Zeka), Vrioni. Kuqezinjtë bëjnë pjesë në grupin e dytë dhe kjo ndeshje ishte e parafundit ku do të pasohet nga sfida e fundit zyrtare ndaj Estonisë në datë 16 tetor. Alban Bushi pas përfundimit të ndeshjes gjatë

interesimit të medias u shpreh: "Mendojmë të luanim bukur gjatë gjithë lojës, skuadra u lodh në fund të ndeshjes. Ekipi i Spanjës ka shumë mundësi, është një fitore e merituar nga ata. Sa i përket grumbullimit të futbollistëve të U-21 nga trajneri Panuçi, më vjen mirë që po i shërbejmë ekipit kombëtar A, ku në ndeshjen miqësore të mbërmshe ndaj Jordanisë luajtën 5 futbollistë që kanë shkuar nga Shpresat. Kemi edhe ndeshjen e fundit të eliminatorëve në Estoni me 16 tetor ku duhet të fitojmë."

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hij.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtom të bëhet as.
14. Janë felinë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkist i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkrimtare
23. Të parat në cilësi.
25. Mbyllin një shtëpi.
26. Mbeten në fund.
27. Qendër në kaos.
28. Ka bërë piktoreskë një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra... e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.
34. Rastet pa set.
36. Rastisin në krye.

37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indici).
44. Triplet e Trëndafilit me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

VERTIKAL

1. Fillojnë praktikën.
2. Britma e Arkimedit.
3. Ekstrema në trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parker regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.
10. Një i fundit mbi të gjithë
11. Kufizojnë tatimet
13. Janë nomadë.
15. Panik pa kufij.
16. Fryn detin
17. Sidney regjisor i Serpico.
18. Jep alarmin.
20. Fillojnë nazet.
24. Janë llogari.
25. Alan regjisor.
29. Roman regjisor.
32. Eshhtë X ajo e sulmit.
33. Kapen të parat.
35. Një provë... inteligjence.
37. Një markë lap top.
40. Fillojnë matjet.
41. Rruge e Ferenc Molnar.
42. Qerre pa qe.
45. Fillojnë lirinë.
46. Fillojnë vallen.
48. Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprind hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rrallë.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishite muzikanti që nuk përsërite.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.
35. Nuk shuhej dot nga Tantalit.

VERTIKAL


36. Desnuda e Goya-s.
37. Ruhet ajo sportive.
39. Vetëvraska e samurai.
41. Drita pa kufizj.
43. Eshhtë yll i skuadrës.
44. I dashuri i Aidas.
46. Eshhtë zhurmë
47. Ishite lulja e haresës.
1. James, armiku i Sherlock Holmes.
2. Eshhtë edhe ajo saudite.
3. Imami aktore
4. I kanë çift turket.
5. Inicialet e Seagal aktor.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinas.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës
24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
26. Njëllioj për latinët.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rrallë është përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	1								
6			3	4	8	5			
8	9				5				3
			4					8	
	7			6				1	
				9				7	2
5									6
		2	7		9	4			
								2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	1	3	9	2	4	8	6	5
6	4	5	1	8	3	7	2	9
8	9	2	5	6	7	1	3	4
2	5	8	6	4	9	3	7	1
9	6	1	7	3	8	4	5	2
3	7	4	2	1	5	6	9	8
1	8	9	3	7	2	5	4	6
4	2	7	8	5	6	9	1	3
5	3	6	4	9	1	2	8	7

Argëtim filozofik

- Asgjë nuk është më e shtrenjtë se sa ajo që blihet me lutje..!
- Eshhtë e rrezikshme të kesh të drejtë, kur qeveria e ka gabim...
- Eshhtë shumë më finike t'i shmangesh situatave të pakëndshme përmes heshtjes sesa t'i tejkalosh ato përmes grindjes
- Një burrë i mirë është shpëtimi i gruas, një grua e mirë është shpëtimi i familjes
- Më mungojnë ata që nuk mund të jenë me mua dhe jo ata që zgjedhën të mos jenë me mua
- Mos i jep 1000 gjëra një personi që di të numërojë deri në 100

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2	1	11	2	7	
4	9	12	4	11	2	12	4	11	13	15	8	2
1	12	4	2	12	4	11	6	1	8			
4	11	2		5	10	3	1	15	12	2		
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12
3			5	10	3	1	14	4	6	1		
4	12	1		5	1	7	2	12	11	4	3	
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4
12	11	1		9	4		12	6		8	15	8
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14
7	2	14	4	12								
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12

- -Nuk ka rëndësi se kush, mjafton që dikush të dëgjon me të vërtetë..!
- -Mos lejo kurrë që zemra të vendosi 'presje' aty
- ku mendja është e sigurt që duhet vendosur 'pikë'

Thënie të mençura

- -Pasuritë më të mëdha janë ato që nuk i sheh dot syri, por i gjen zemra
- -Nëse i mohon të vërtetën një femër, dije se ajo do të bëjë të besosh vërtetë gënjeshtret e sajë
- -Në varrimin e së vërtetës, gënjeshtra mbajti një fjalim prekës

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

1. RIZA
7. HIJE
11. DIPLOMATIK
12. AS
14. ZINJ
16. MAUPASSANT
18. SALGAR
19. ANARKIST
21. GJAKU
22. SUSANNA
23. CILËSI
25. SHTËPI
26. MBETEN
27. KAOS
28. PICTURESQUE
30. CAMUS
31. MOTRA
33. KONFUZION
34. RASTET
36. RASTISIN

FJALËKRYQI (2)

1. DR. LANG
6. HOTELIER
11. KUSH
13. DJALL
14. RALLË
15. SAMOTRAKIAS
17. BOTUESI
18. INFLEKSION
20. SAMURAI
21. KAFEJE
22. HARK
23. EMËRORE
25. MZIKANT
28. AVOKAT
29. QERRE
30. ADOLESHENTË
32. PLANETI
35. TANTALIT

